Funded by the European Union

# RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË UJËRAVE TË KOSOVËS 2017-2036

Promoting Universal Access to Clean Water

Let's do it Peja!

Shkurt, 2023

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.
Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Let's Do It Peja, zbatues i projektit "Promovimi i Qasjes Univerzale në Ujë të Pastër" dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Zyrës në Prishtinë.

Funded by the European Union

# R A P O R T

## PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË UJËRAVE TË KOSOVËS 2017-2036

Promoting Universal Access to **Clean Water**

Let's do it Peja!

## Përmbajtja


SHKURTESAT ... 6

1. HYRJE ... 7

1.1 PROCESI I HARTIMIT TË STRATEGJISË ... 7

1.2 FUSHËVEPRIMI I STRATEGJISË ... 8

1.3 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE ... 9

1.4 TREGUESIT OBJEKTIVISHT TË VERIFIKUESHËM ... 9

2. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË ... 10

3. METODOLOGJIA ... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.3

3.1 INTERVISTAT/PYETËSORËT ... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.3

3.2. SHQYRTIMI I LITERATURËS ... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.3

3.3 ANALIZA E TË DHËNAVE ... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.4

4. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË ... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.5

4.1 PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT STRATEGJIK 1: ... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.5

4.2 PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT STRATEGJIK 2: ... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.30

4.3 PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT STRATEGJIK 3: ... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.8

4.4 PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT STRATEGJIK 4: ... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.5

5. PËRMBLEDHJE E PROGRESIT DHE REKOMANDIME ... 485

5.1 MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË ... 485

5.2 VLERËSIMI SIPAS OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË DHE REKOMANDIMET ... 486

SHTOJCA 1: TREGUESIT OBJEKTIVISHT TË VERIFIKUESHËM TË STRATEGJISË ... 653

SHTOJCA 2: PYETËSORËT PËR INSTITUCIONET/ORGANIZATAT QË KANË ROL NË ZBATIMIN E STRATEGJISË ... 710

## Lista e figurave

Figura 1: Paraqitja grafike e progresit në përmbushjen e objektivit strategjik 1 ........ 50
Figura 2: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 2 ........ 52
Figura 3: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 3 ........ 53
Figura 4: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 4 ........ 55
Figura 5: Përmbledhje tabelare e  progresit në zbatimin e Strategjisë........ 56

## Shkurtesat

| | |
|---|---|
| ARPL | Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore |
| ARRU | Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| BE | Bashkimi Europian |
| DKU | Direktiva Kornizë e Ujërave |
| FLOWS | Projekti: Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë e Ujërave |
| IHMK | Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës |
| ISR | Indeksi Standard i Reshjeve |
| KfW | Banka Gjermane për Zhvillim |
| KNU | Këshilli Ndërministror për Ujëra |
| KRU | Kompania Rajonale e Ujit |
| KU | Kompania e Ujitjes |
| MASHT | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| MBPZHR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| ME | Ministria e Ekonomisë |
| MIRU | Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifkimit Hapësinor |
| MMPHI | Ministria e Mjedisit, Planifkimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| MZHE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik (tash Ministria e Ekonomisë) |
| NJZP | Njësia e Zbatimit të Projektit (anglisht: "Project Implementation Unit") |
| PMPL | Plani i Menaxhimit të Pellgjeve Lumore |
| UA | Udhëzim Administrativ |
| UPF | Uji i Pafaturuar |
| VNSM | Vlerësimi i Ndikimit Social dhe Mjedisor |

# 1. HYRJE

*Strategjia Shtetërore për Ujërat e Kosovës 2017-2036* (në tekstin e mëtutjeshëm: *Strategjia*) është hartuar në përputhje me *Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës* (në tekstin e mëtutjeshëm: *Ligji për Ujëra*). Strategjia është një dokument i planifikimit afatgjatë i cili përmban vizionin, misionin, objektivat, qëllimin, veprimet, aktivitetet dhe masat për zhvillimin e politikave ujore në Republikën e Kosovës. Ajo përcakton objektivat strategjike dhe drejtimet e zhvillimit të resurseve ujore duke filluar nga gjendja ekzistuese, kërkesat aktuale dhe të ardhshme për ujë, strukturat menaxhuese, detyrimet ndërkombëtare, kërkesat për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes dhe cilësisë së resurseve ujore, mbrojtjen nga ujërat, dhe mbrojtjen e ekosistemeve ujore.

Strategjia është një dokument planifikues në bazë të të cilit promovohen reforma në sektorin e ujërave me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore vendore dhe arritjes së standardeve të Bashkimit Evropian (BE) përkitazi me administrimin dhe menaxhimin e resurseve ujore.

Në pajtim me kërkesat e Ligjit për Ujëra, Strategjia është hartuar për një afat kohor prej 20 vitesh dhe vlen për periudhën kohore të aprovuar. Strategjia aktuale është planifikuar të zbatohet në katër periudha kohore: periudha e parë do të përfshijë vitet 2017 deri më 2021, periudha e dytë 2022-2026, periudha e tretë 2027-2031 dhe periudha e katërt 2032-2036.

Hartues dhe përgjegjës kryesor për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI – ish Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), në bashkëpunim me hisedarët e sektorit të ujërave. Partnerët kryesorë gjatë procesit të hartimit të Strategjisë kanë qenë Zyra e Kryeministrit/Këshilli Ndërministror për Ujëra (KNU), Ministria e Ekonomisë (ME - ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik) si përgjegjëse për Ndërmarrjet Publike dhe Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), administratat komunale, sektori i biznesit dhe shoqëria civile.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka qenë gjithëpërfshirës, në konsultim të vazhdueshëm me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal, kompanitë rajonale të ujit, shoqërinë civile, profesionistët e rinj, përfaqësuesit e shfrytëzuesve të ujit dhe partnerët zhvillimorë.

## 1.1 Procesi i hartimit të Strategjisë

Strategjia është iniciuar dhe hartuar në pajtim me *Udhëzimin administrativ Nr. 02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë për Përgatitjen dhe Aprovimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve për Implementimin e Tyre*[1].

Nisma për hartimin e Strategjisë ishte marrë nga Zyra e Kryeministrit (përmes Këshillit Ndërministror për Ujëra) si dhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (tash Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës). Mjetet për financimin e hartimit të Strategjisë ishin siguruar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, kështu që, në shtator të vitit 2012, ishte angazhuar kompania konsulente për mbështetjen e MMPHI/Departamenti i Ujërave (aso kohe, tani i shndërruar në Autoritetin e Rajonit të Pellgjeve Lumore - ARPL) për këtë qëllim. Strategjia ishte finalizuar në vitin 2017 kur edhe ishte miratuar nga Qeveria e pastaj edhe nga Kuvendi i Kosovës.

## 1.2 Fushëveprimi i Strategjisë

Strategjia Shtetërore e Ujërave përcakton prioritetet sektoriale për fushën e ujërave, të cilat parashikohet të realizohen sipas periudhave kohore (afatshkurtra 5 vjet, afatmesme 10 vjet, dhe afatgjata 20 vjet) për të gjitha institucionet që kanë rol në menaxhimin e ujërave (duke përfshirë Qeverinë, MMPHI, MBPZhR, ME, KRU-të, komunat). Strategjia Shtetërore e Ujërave sipas ligjit do të duhej të merrej vetëm me resurset ujore, por meqë asnjë dokument politik tjetër nuk trajtonte edhe shërbimet e

[1] Ky UA më vonë është zëvendësuar me *UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (QRK) NR. 07/2018 PËR PLANIFIKIMIN DHE HARTIMIN E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE DHE PLANEVE TË VEPRIMIT*

ujit, dhe meqë pjesë e administrimit të resurseve ujore është edhe shfrytëzimi i ujërave, ishte arritur dakordimi mes palëve që strategjia të trajtojë edhe nevojat për furnizim me ujë dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ujitjen.

Rrjedhimisht, Strategjia si njëri nga dokumentet kryesore të planifikimit dhe menaxhimit të resurseve ujore i adreson çështjet më të rëndësishme të ujërave duke përfshirë:

*a) Shfrytëzimin e ujërave*

- furnizimi me ujë të pijshëm
- prodhimi i ushqimit
- ujitja e tokave bujqësore
- industria ekstraktive dhe përpunuese
- gjenerimi i energjisë elektrike
- peshkataria
- turizmi, sporti dhe rekreacioni

*b) Mbrojtjen e ujërave*

- grumbullimi i ujërave të ndotura nga amvisëria (sistemi i kanalizimit publik)
- grumbullimi i ujërave të ndotura nga industria ekstraktive dhe përpunuese (sisteme të veçanta)
- grumbullimi i ujërave atmosferike (shiu, bora etj. - sisteme komunale)
- trajtimi i ujërave të ndotura (infrastruktura)
- monitorimi i parametrave të shkarkimit të ujërave të ndotura në recipient

*c) Mbrojtjen nga ujërat*

- Vërshimet (rregullimi i segmenteve lumore, masat biologjike, muret mbrojtëse nga vërshimet, gabionet, argjinaturat, etj.)
- Kapërderdhjet (muret mbrojtëse, ngritje të terrenit me mbushje artificiale, etj.)
- Erozioni (bankinat malore, pyllëzimi, mbrojtje të pyjeve, etj.)
- Kullimi (kanalet e drenazhimit, etj.)
- Tharja (kanalet e drenazhimit, mbushje, injektime, etj.)
- Thatësia (sistemet për paralajmërim të hershëm)
- Ndryshimet klimatike

## 1.3 Objektivat Strategjike

Strategjia është e konceptuar që për periudhën 20-vjeçare të arrijë katër qëllime kryesore të nivelit të lartë që janë:

(i) Mbrojtja dhe zhvillimi i resurseve ujore
(ii) Menaxhimi i integruar i resurseve ujore
(iii) Valorizimi ekonomik i resurseve ujore
(iv) Përafrimi me direktivat dhe standardet e BE-së për fushën e ujërave

Këto qëllime të Strategjisë janë mishëruar në pesë Objektivat Strategjike të përshkruara si më poshtë:

1. **Shfrytëzimi i ujërave**: *"Të ndahet dhe mbikëqyret në mënyrë të qëndrueshme e drejta për shfrytëzimin e burimeve ujore të Kosovës tek të gjithë shfrytëzuesit e ujit për të garantuar ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin, për të maksimizuar përfitimet ekonomike nga përdorimet tjera të ujit, duke marrë në konsideratë ndryshimin e regjimeve hidrologjike, eliminimin e mungesave të ujit dhe duke respektuar parimin e menaxhimit të qëndrueshëm."*

2. **Mbrojtja e ujërave:** *“Rregullimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve që ndikojnë në ujëra në mënyrë proporcionale, efiçiente dhe efektive, në mënyrë që të arrihen objektiva mjedisore të arsyetuara nga aspekti ekonomik për trupat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore duke respektuar parimet e menaxhimit të qëndrueshëm.”*

3. **Mbrojtja nga ujërat:** *“Arritja e niveleve të pranueshme të mbrojtjes së popullsisë dhe pronës nga efektet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë vërshimet, rrëketë dhe erozionin në një mënyrë ekonomikisht të ekuilibruar dhe me kosto efektive.”*

4. **Qeverisja:** *“Të themelohet dhe të mirëmbahet një sistem i qeverisjes së ujit që është i drejtë, transparent, efikas, i koordinuar dhe me kapacitete të atillë profesional dhe teknik që të jetë në gjendje të mbështesë në mënyrë efektive arritjen e objektivave strategjike për shfrytëzimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave dhe mbrojtjen nga ujërat, duke përfshirë zbatimin e një sistemi të informacionit për ujërat për të monitoruar, vlerësuar, interpretuar dhe informuar palët e interesuara për të gjitha aspektet e kësaj Strategjie.”*

5. **Objektivi horizontal:** *“Të arrihet përputhshmëri afatgjatë me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian në sektorin e ujërave, fillimisht nëpërmjet adoptimit të sistemeve kompatibile të legjislacionit dhe planifikimit, dhe më vonë me zbatimin hap pas hapi të masave praktike të zbatimit.”*

### 1.4 Treguesit objektivisht të verifikueshëm

Objektivat strategjike të përcaktuara më sipër janë të shprehura në formë narrative. Një përshkrim i tillë tekstual është i domosdoshëm për ta kuptuar objektivin, por nuk siguron një monitorim dhe raportim lehtë të verifikueshëm. Prandaj, janë definuar një numër i treguesve objektivisht të verifikueshëm që janë të matshëm/kuantitativ.

Treguesit janë të grupuar në dy nivele: "titullarë" dhe "të hollësishëm", ku *treguesi titullar* ofron informacionin "në shikim të shpejtë" për çështjen e caktuar ndërkaq informatat shtesë gjenden në *treguesit e hollësishëm*.

Treguesit janë nxjerrë drejtpërdrejt nga Objektivat Strategjike dhe ato ishin planifikuar të raportohen në baza vjetore.

Një listë e plotë e treguesve objektivisht të verifikueshëm të përcaktuar me Strategji është dhënë në *Shtojcën 1* të këtij raporti.

## 2. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Është me rëndësi thelbësore që zbatimi i një plani strategjik të monitorohet dhe të vlerësohet në vazhdimësi dhe në mënyrë sistematike. Kjo mundëson që të konstatohet se (i) a po ndiqet kursi i përcaktuar me plan strategjik, (ii) cilat janë problemet eventuale për zbatimin e veprimeve të planifikuara me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara, (iii) arsyet për vonesa eventuale në zbatimin e veprimeve të përcaktuara, dhe (iv) cilët janë hapat e ardhshëm.

Me *Udhëzimin Administrativ nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit* (neni 16), ministria udhëheqëse duhet të përgatisë 2 raporte:

- Raportin gjashtëmujor për zbatimin e planit të veprimit
- Raportin vjetor mbi zbatimin e dokumentit strategjik.

Sipas *Manualit për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit* (në tekstin e mëtutjeshëm: *Manuali*) Ministria udhëheqëse (në këtë rast MMPHI) është përgjegjëse për monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të dokumentit të miratuar strategjik dhe nëse është e nevojshme, të ndërmarrë veprime për të siguruar zhvillimin me kohë dhe në mënyrë efektive të aktiviteteve të përcaktuara në planin e veprimit.

Funksionet kryesore të ministrisë udhëheqëse në procesin e monitorimit dhe raportimit janë si në vijim:

- Të krijojë një mekanizëm efektiv monitorimi dhe raportimi dhe të sigurojë zbatimin e tij.
- Të mbledh informacion nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e dokumentit strategjik dhe planit të tij të veprimit.

- Të përgatis raportet e rregullta vjetore mbi zbatimin e dokumentit strategjik dhe raportin gjashtëmujor për zbatimin e planit të veprimit.
- Të organizojë punën e organit ndërministror të koordinimit, për të cilin ato ofrojnë funksione të sekretariatit.
- Të nis diskutimet për çështje problematike, nëse është e nevojshme.
- Të publikojë raportet e rregullta në uebfaqen e ministrisë pas miratimit të tyre nga organi përkatës.

Sipas këtij Manuali, **monitorimi** i zbatimit të një dokumenti strategjik dhe rrjedhimisht raporti i monitorimit duhet të fokusohet në sa vijon:

- Sa janë arritur objektivat krahasuar me objektivat e treguesit (të paktën për dy vitet e fundit);
- A janë përfunduar me kohë veprimet e planifikuara;
- Sa janë shfrytëzuar resurset financiare të planifikuara;
- Cilat kanë qenë pengesat kryesore në zbatim;
- Cilat janë masat korrektuese.

**Vlerësimi** është një proces i cili ka për qëllim për të analizuar suksesin e zbatimit të strategjisë, duke identifikuar se çfarë ka shkuar mirë, duke shqyrtuar arsyet pse ka shkuar keq nëse diçka ka shkuar keq, dhe pastaj duke ri-përshtatur drejtimin strategjik në përputhje me rrethanat.

Për të fokusuar vlerësimin është e nevojshme që të përcaktohen pyetjet e vlerësimit. Pyetjet e vlerësimit janë ato pyetje që vlerësuesit duhet t'iu japin përgjigje në raportin e tyre të vlerësimit.

Pyetjet e vlerësimit që rekomandohen me Manual, për secilin prej dimensioneve të vlerësimit, janë si vijon:

a) *Relevanca:*
   - A janë ende të vlefshme objektivat e strategjisë?
   - A u përgjigjet strategjia nevojave?
   - Sa mirë u përgjigjen veprimet/produktet e strategjisë problemit/objektivave?
   - Sa është përshtatur mirë reforma me ndryshimet e pasuese në kontekstin në të cilin reforma është strukturuar (ndryshimet në nevoja, në politika, etj.)?

b) *Efikasiteti:*
   - A është veprimi/aktiviteti me kosto efektive?
   - Deri në çfarë mase shpenzimet e përfshira arsyetohen, duke pasur parasysh ndryshimet/efektet që janë arritur?
   - Cilat janë mënyrat e tjera të përdorimit të resurseve që kanë sjell më shumë rezultate apo që kanë përdorur burime në mënyrë të matur, por duke ruajtur të njëjtin nivel të arritjeve?
   - A mund të arrihen të njëjtat rezultate duke përdorur më pak resurse ose përmes një kombinimi më të mirë/ndryshëm të resurseve të përdorura?
   - Sa efikas (i lehtë) është procesi i zbatimit?

c) *Efektiviteti:*
   - Në çfarë mase janë arritur/ka gjasa të arrihen objektivat?
   - A arrihen/a janë arritur objektivat në kohë?
   - Deri në çfarë mase efektet e vërejtura korrespondojnë me objektivat? Cilat janë arsyet kryesore pse nuk po arrihen objektivat?
   - Cilat janë arsyet e suksesit?

d) *Ndikimi:*
- Çfarë ka ndodhur si rezultat i strategjisë?
- Çfarë ndryshimi ka bërë strategjia për grupet e ndryshme të përfituesve (dhe për publikun e gjerë në përgjithësi)?
- Si janë prekur g:rupet e ndryshme të synuara?

e) *Qëndrueshmëria:*
- A do të vazhdojnë përfitimet pas zbatimit të strategjisë?
- A mund të jenë ndikimet afatgjata?
- Çfarë mund të bëhet për të siguruar që ato të mbeten të qëndrueshme?
- Cilat rregullime institucionale mundësojnë ruajtjen e përfitimeve të arritura?

Sipas Manualit, raportet e dokumenteve strategjike duhet të jenë një narrativë mbi performancën, duke përdorur dëshmi. Për përpilimin e një narrative të tillë, filtrimi ose zgjedhja e informacionit përkatës është vendimtare. Përveç kësaj narrative të fokusuar, duhet të ofrohet një përmbledhje ose një përshkrim i sintetizuar i progresit në secilin aktivitet, aty ku është e rëndësishme në ciklin e dhënë të raportimit.

Sipas informacioneve në dispozicion, **MMPHI nuk ka zbatuar monitorim dhe raportim** për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit ashtu siç parashihet me UA nr. 07/2018 dhe me Manualin, në këto 5 vite prej se është miratuar Strategjia.

# 3. METODOLOGJIA

Për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë janë shfrytëzuar disa burime të të dhënave si:

1) intervista me përfaqësuesit e MMPHI dhe ministrive/organizatave tjera që kanë rol në zbatimin e Strategjisë,

2) shqyrtimi i literaturës ekzistuese përkitazi me Strategjinë dhe zbatimin e saj,

3) diskutime me njohësit e zhvillimeve që ndërlidhen me zbatimin e Strategjisë.

## 3.1 Intervistat/pyetësorët

Intervistat me përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse dhe atyre që kanë rol në zbatimin e Strategjisë janë zhvilluar përmes pyetësorëve të dërguara si dhe takimeve të organizuara për qëllim të sigurimit të informacionit.

Institucionet e intervistuara janë:
- Këshilli Ndërministror për Ujërat
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Ministria e Ekonomisë,
- Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit,
- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës,
- Kompanitë Rajonale të Ujit,
- Kompanitë Rajonale të Ujitjes,

Pyetjet për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë janë bazuar në objektivat strategjike dhe treguesit e verifikueshëm për secilin prej objektivave strategjikë (shih *Shtojcën 1* të këtij raporti).

## 3.2. Shqyrtimi i literaturës

Për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë është shfrytëzuar literatura si vijon:


- ARRU. 2022. *Raport Vjetor i Performancës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovë 2021.* Prishtinë;
- ARRU. 2017. *Raport Vjetor i Performancës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovë 2016*. Prishtinë;
- ASK. 2022. *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2022*. Prishtinë;
- ASK. 2017. *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2017*. Prishtinë;
- AMMK. 2020. *Raport për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë 2020*. Prishtinë;
- AMMK. 2016. *Raport për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë 2016*. Prishtinë;
- MBPZHR. 2021. *Bujqësia e Kosovës në Numra*. Prishtinë.
- MBPZHR, 2020. Master Plani i Ujitjes për Kosovë dhe Korniza Investuese
- IHMK, 2022. Draft Strategjia për Veprimtari Hidrometeorologjike të Kosovës


## 3.3 Analiza e të dhënave

Pyetësorët e veçantë të përgatitur paraprakisht (shih *Shtojcën 2*) u janë shpërndarë institucioneve/organizatave që kanë rol në zbatimin e Strategjisë me qëllim të marrjes së informacionit për progresin e arritur në zbatimin e Strategjisë, respektivisht për aktivitetet e ndërmarra nga institucionet përkatëse në zbatimin e veprimeve të planifikuara me Strategji. Përgjigjet e pranuara janë shqyrtuar veç-e-veç dhe janë përdorur për vlerësimin e zbatimit. Mbi bazën e këtyre përgjigjeve dhe mbi bazë e të dhënave nga raportet dhe informacionet tjera të disponueshme që kanë relevancë për progresin në zbatimin e Strategjisë, është vlerësuar progresi dhe është hartuar ky raport.

Duhet theksuar se jo të gjitha institucionet/organizatat të cilave iu janë dërguar pyetësorët i kanë ofruar informacionet e kërkuara. Në anën tjetër, edhe përgjigjet e dërguara në disa raste nuk kanë qenë të plota dhe rrjedhimisht nuk kanë ofruar informacionet e nevojshme për vlerësimin e zbatimit të veprimeve/masave të planifikuara me Strategji.

Një problem i veçantë në kompletimin e monitorimit ka paraqitur fakti se për një numër të konsiderueshëm të veprimeve në Strategji nuk janë përcaktuar treguesit e verifikueshëm për matjen e zbatimit të veprimeve/masave të planifikuara (veprimet 1.5.2, 1.6.2, 1.6.3, 1.7, 1.8.3, 1.9.1, 1.9.2, 1.9.3, 1.9.4, 1.10.1, 1.10.2, 1.10.3, 2.1.2, 2.1.3, 2.2, 2.3, 2.4, 2.6.1, 2.7.1, 2.7.2, 2.8.2, 2.8.3 etj.). Në anën tjetër, treguesit e verifikueshëm për disa prej veprimeve janë joadekuat (p.sh. te masa 1.4 Ngritja e shkallës së pagesave, te veprimet 1.4.1, 1.4.2, 1.4.3 është dhënë si tregues për zbatimin e këtij veprimi – përqindja (%) e UPF që nuk ka të bëjë me shkallën e pagesave po me humbjet e ujit).

Duke i pasur parasysh të gjitha këto probleme, është adoptuar një sistem i thjeshtë i vlerësimit kualitativ të progresit në zbatimin e Strategjisë, për secilin prej veprimeve të planifikuara bazuar në informacionet në dispozicion. Ky sistem i vlerësimit konsiston në 4 nivele të progresit si vijon:

(i) Pa progres;

(ii) Progres i vogël;

(iii) Progres i pjesshëm;

(iv) Progres substancial.

Bazuar në progresin e vlerësuar për secilin prej veprimeve i cili është paraqitur në formë tabelare, pastaj është bërë vlerësimi i progresit në zbatimin e objektivave strategjik përkatës duke u bazuar mbi progresin në zbatimin e veprimeve dhe masave respektive të planifikuara.

Konkluzionet finale të vlerësimit janë të bazuara në tërësinë e të gjitha të dhënave të disponueshme nga të gjitha burimet e të dhënave për masat/temat specifike që ndërlidhen me objektivat strategjikë.

# 4. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË

Përshkrimi i progresit të arritur në zbatimin e Strategjisë do të bëhet për secilin prej objektivave strategjikë. Progresi në zbatimin e veprimeve dhe masave të planifikuara sipas objektivave strategjikë është paraqitur në formë tabelare si më poshtë.

## 4.1 Progresi kundrejt Objektivit Strategjik 1:

*"Të ndahet dhe mbikëqyret në mënyrë të qëndrueshme e drejta për shfrytëzimin e burimeve ujore të Kosovës tek të gjithë shfrytëzuesit e ujit ashtu që të garantohet për të gjithë qasja në ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin dhe të maksimizohen përfitimet ekonomike nga përdorimet tjera të ujit, duke marrë në konsideratë ndryshimin e regjimeve hidrologjike, eliminimin e mungesës së ujit dhe duke respektuar parimin e menaxhimit të qëndrueshëm."*

Për zbatimin e këtij objektivi strategjik me Strategji janë planifikuar *10 masa*, si në vijim:

### MASA 1.1: Rritja e kapaciteteve për akumulimin dhe ruajtjen e resurseve ujore

Vlerësimi i nevojave të tashme dhe të ardhshme për ujë dhe rrjedhimisht për ndërtimin e akumulimeve të reja do të bëhet përmes Planeve për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore (PMPL). Në mungesë të këtyre planeve (pasi që të njëjtat nuk janë kryer ende), Strategjia ka paraparë që vlerësimi i nevojave për rritjen e kapacitetit akumulues të ujërave të bëhet bazuar në Masterplanin e Ujërave 1983-2003, duke rivlerësuar akumulimet e planifikuara me këtë Masterplan bazuar në kontekstin aktual demografik, ekonomik dhe planifikues.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.1:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 3 veprime si vijon:

Veprimi 1.1.1: Studimi i fizibilitetit për rritjen e kapacitetit të akumulimit të ujit.

**a) Planifikimi**

*Të hartohet një studim i fizibilitetit i cili do të përfshijë të gjitha pellgjet e lumenjve të Kosovës dhe të realizohet në periudhën kohore 2017-2019. Kostoja e parashikuar për hartimin e këtij studimi ishte vlerësuar në 2,000,000 EUR ndërsa si autoritet përgjegjës ishte përcaktuar Ministria e Zhvillimit Ekonomik (tash Ministria e Ekonomisë).*

**b) Zbatimi**

- Nuk është hartuar ende një studim i fizibilitetit për vlerësimin e nevojave për rritjen e kapacitetit akumulues të ujërave për të gjitha pellgjet e lumenjve (një gjë e tillë tani planifikohet të kryhet në kuadër të projektit FLOWS, përmes kredisë së Bankës Botërore).
- Është hartuar studimi i fizibilitetit për akumulimet Firajë dhe Shtime për hidrosistemin e Lepencit (në vitin 2020 përmes grantit nga WBIF).
- Janë planifikuar për vitin 2023, me financim të MMPHI, studimet e fizibilitetit për akumulimet: Dragaqinë, Pollatë dhe Drelaj.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 1.1.2: Mbështetja në zbatim – rritja e kapacitetit të depozitimit të ujit.

**a) Planifikimi**

*Mbështetje në përgatitjen e projekteve prioritare të identifikuara më lartë në 1.1.1 duke përfshirë hartimin e projektit si dhe dokumentacionin tenderues. Ky veprim ishte planifikuar të zbatohet gjatë periudhës kohore 2019-2021 dhe ishte vlerësuar të ketë kosto prej 2,000,000 EUR.*

**b) Zbatimi**

- Nuk janë hartuar ende dokumentacioni projektues dhe tenderues për asnjërën prej digave.
- Është në proces hartimi i projektit ideor ("preliminary design") dhe studimit të VNMS për digën e Firajës në lumin Lepenc (grant nga WBIF).
- Në kuadër të projektit FLOWS është formuar NJZP për akumulimin e Kamenicës (mbetet të vendoset a do të jetë në Kremenatë apo Desivojcë) hartuar studimi i fizibilitetit për akumulimin në lumin Lepenc (në vitin 2020).

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 1.1.3: Ndërtimi – rritja e kapacitetit për akumulimin e ujit.

**a) Planifikimi**

*Ndërtimi i digave të reja për akumulimin e ujit. Ky veprim ishte planifikuar të kryhej gjatë periudhës kohore 2020-2026 dhe kostot për zbatimin e tij ishin vlerësuar në 152 milion EUR.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka filluar ende ndërtimi i asnjërës prej digave.
- Është krijuar NJZP për akumulimin e Kamenicës (lokacioni mund të jetë Kremenata apo Desivojca).

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

## MASA 1.2: Rritja e efiçencës në shfrytëzimin e ujit

Efiçenca e shfrytëzimit të ujit nga konsumatorët ka të bëjë me të gjithë shfrytëzuesit e ujit duke përfshirë konsumatorët:

- Shtëpiak
- Ujitje
- Industri

Efiçenca e shfrytëzimit ishte planifikuar të përmirësohej duke zbatuar parimin *ndotësi paguan*, si dhe parimin *shfrytëzuesi paguan* p.sh. përmes nismave që stimulojnë shfrytëzuesit që të kursejnë ujin.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.2:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 5 veprime si vijon:

Veprimi 1.2.1: Zvogëlimi i rrjedhjeve nga sistemet e furnizimit me shumicë.

**a) Planifikimi**

*Të vlerësohet niveli i humbjeve nga rrjedhjet e sistemeve të furnizimit të ujit me shumicë, të përcaktohen shkaqet kryesore (teknike, të tjera), dhe të nxjerrën planet për adresimin e shkaqeve kryesore dhe zbatimin e tyre. Ky aktivitet ishte planifikuar të zbatohej në tërë fazën e e 1-rë planifikuese 2017-2022.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka informacion.

  *(Shënim: NH "Ibër-Lepenci" nuk ka dërguar informacion ndërsa të dhënat e dërguara nga KU "Radoniqi-Dukagjini" dhe KU "Drini i Bardhë" nuk japin informacion për trendin e humbjeve gjatë periudhës 2017-2021 që do të mundësonte vlerësimin e progresit.)*

**c) Vlerësimi i progresit**

n/a

Veprimi 1.2.2: Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e furnizimit me ujë.

**a) Planifikimi**

*Të vlerësohet niveli i humbjeve nga rrjedhjet e sistemeve të furnizimit të ujit, të përcaktohen shkaqet kryesore (teknike, të tjera), dhe të nxjerrën planet për adresimin e shkaqeve kryesore dhe zbatimin e tyre. Ky aktivitet ishte planifikuar të zbatohej në tërë fazën e e 1-rë planifikuese 2017-2022.*

**b) Zbatimi**

- Të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të) i kanë hartuar Strategjitë 5-vjeçare për zvogëlimin e humbjeve të ujit (2018-2022).
- Humbjet e ujit në nivel të sektorit janë zvogëluar për 3 pikë të përqindjes: nga 58% në 55%.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i plotë.

Veprimi 1.2.3: Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e ujitjes.

**a) Planifikimi**

*Të vlerësohet niveli i humbjeve nga rrjedhjet e sistemeve të ujitjes, të përcaktohen shkaqet kryesore (teknike, të tjera), dhe të nxjerrën planet për adresimin e shkaqeve kryesore dhe zbatimin e tyre. Ky aktivitet ishte planifikuar të zbatohej në tërë fazën planifikuese 2017-2022..*

**b) Zbatimi**

Nuk ka informacion.

*(Shënim: NH "Ibër-Lepenci" nuk ka dërguar të dhëna ndërsa të dhënat e dërguara nga KU "Radoniqi-Dukagjini" dhe KU "Drini i Bardhë" nuk japin informacion për trendin e humbjeve gjatë periudhës 2017-2021 që do të mundësonte vlerësimin e progresit.)*

**c) Vlerësimi i progresit**

n/a

Veprimi 1.2.4: Rritja e efikasitetit së shfrytëzuesve të ujit për ujitje.

**a) Planifikimi**

*Me qëllim të rritjes së efikasitetit të shfrytëzuesve të ujit për ujitje, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ishte planifikuar që të zhvillojë aktivitetet vijuese:*

- *Monitorimi i shfrytëzimit të ujit për ujitje*
- *Analiza e llogarive ekonomike*
- *Ofrimi i shërbimeve këshilluese*
- *Administrimi i skemave ndihmëse.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka informacion se janë zhvilluar aktivitetet e planifikuara.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

Veprimi 1.2.5: Rritja e efiçencës së shfrytëzimit të ujit në industri.

**a) Planifikimi**

*Me qëllim të rritjes së efikasitetit të shfrytëzuesve të ujit për ujitje, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (tash Ministria e Ekonomisë) ishte planifikuar që të zhvillojë aktivitetet vijuese:*

- *Monitorimi i shfrytëzimit të ujit për industri*

- *Modelet specifike për industri*
- *Promovimi i shfrytëzimit të ujit në industri.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka informacion se janë zhvilluar aktivitetet e planifikuara.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

## MASA 1.3: Të sigurohet ushtrimi i kontrollit mbi të gjitha burimet ujore

Vendosja e kontrollit mbi shfrytëzimin e burimeve ujore ashtu siç kërkohet në Ligj duhet të bëhet në bazë të lejeve ujore, respektimit të kushteve të lejes (p.sh. niveli i shfrytëzimit/nxjerrjes) duhet të monitorohet dhe nëse ka nevojë të merren masa zbatuese.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.3:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 3 veprime si vijon:

Veprimi 1.3.1: Fushata për zbatimin e lejeve ujore.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim ka të bëjë me shfrytëzimin e ujërave nga mjedisi, p.sh. lumenjtë, liqenet natyrore dhe trupat ujore nëntokësore. Shfrytëzimi (marrja) i paligjshëm i ujërave nga objektet e ndërtuara nga njeriu është adresuar me veprimin e përshkruar më poshtë.*

*Ky veprim përbëhet nga një numër elementesh:*

- *Identifikimi i shfrytëzueseve ilegal të ujërave;*
- *Lëshimi i vërejtjeve për detyrimin e zbatimit të ligjit që kërkon marrjen e lejes për shfrytëzimin e ujërave ose ndërprerjen e menjëhershme të aktivitetit të shfrytëzimit të ujërave;*
- *Lëshimi i lejeve të reja;*
- *Zbatimit i ligjit në rast të vazhdimit të thyerjes së ligjit që obligon marrjen e lejes ujore;*
- *Zbatimi i kushteve të specifikuara në lejen për shfrytëzimin e ujërave.*

*Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ndërsa periudha kohore e zbatimit ishte 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Inspektorati i Ujërave ka hartuar: 806 procesverbale, 143 inicime për kundërvajtje, 287 vendime dhe 218 gjoba administrative;
- ARPL ka ngritur efikasitetin e kontrollit mbi shfrytëzimin e ujit sidomos në vitin 2021 kur janë lëshuar 116 leje ujore (krahasuar me vitin 2020 kur janë lëshuar 68 leje ujore, dhe me vitin 2019 kur janë lëshuar 9 leje ujore).

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 1.3.2: Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit të pijshëm.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim ka të bëjë me shfrytëzimin e paligjshëm të ujit nga rrjeti i ujësjellësit publik (urban edhe rural). Dy raste të ndryshme mund të konsiderohen:*

- *Lidhjet e paligjshme në rrjetin publik të furnizimit me ujë pa kontratë për shfrytëzimin e ujit;*
- *Manipulimi i paligjshëm i ujëmatësve nga ana e konsumatorëve që kanë kontratë me furnizuesin.*

*Identifikimi i lidhjeve të paligjshme do të duhej të jetë i thjeshtë dhe fillimisht do të mund të bëhej duke krahasuar regjistrat e kompanisë së ujësjellësit me listat e pronave, e pastaj të kryhen vizita në objektet që nuk kanë kontrata shfrytëzimi. Kjo qasje mund të kombinohet me një proces të "rregullimit" në rastet e ndërtimeve pa leje. Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve janë KRU-të ndërsa periudha kohore e zbatimit ishte 2017-2022.*

**b) Zbatimi**

- Zvogëlimi i humbjeve të ujit nga ana e KRU-ve prej 3 pikë të përqindjes është rezultat i zvogëlimit të paligjshëm të shfrytëzimit të ujit të pijshëm.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 1.3.3: Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit të ujitjes.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim është paralel me atë për furnizimin me ujë të pijshëm të përshkruar mësipër. Si në rastin e furnizimit me ujë ai përfshin aspektet vijuese:*

- *Identifikimi i lidhjeve të paligjshme*
- *Kompletimi i kontratës në mes të shfrytëzuesit dhe Kompanisë për Ujitje*
- *Vënia e gjobave të pranueshme*

*Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve janë KU-të ndërsa periudha kohore e zbatimit ishte 2017-2022.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka informacion për ndërmarrjen e veprimeve nga KU-të.

**c) Vlerësimi i progresit**

n/a

## MASA 1.4: Zvogëlimi i shkallës së mos-pagesës për shfrytëzimin e ujit nën 5%

Kjo masë vlerëson se element kyç në rritjen e efiçencës së shfrytëzimit të ujit dhe në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të furnizuesve të ujit është zbatimi efektiv i praktikave të sistemit të tarifave për shfrytëzimin e ujit në të gjitha aspektet:

- Shfrytëzimi i ujërave nga mjedisi
- Shfrytëzimi i ujit nga sistemi i ujësjellësit
- Shfrytëzimi i ujit nga sistemi i ujitjes.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.4:** PROGRES SUBSTANCIAL

Për këtë masë janë planifikuar 3 veprime si vijon:

Veprimi 1.4.1: Rritja e nivelit të pagesave për shfrytëzimin e ujit.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim ka të bëjë me pagesat që duhet të bëhen për shfrytëzimin e ujit sipas Ligjit për Ujëra dhe udhëzimeve relevante administrative.*

*Ky veprim përbëhet nga një numër elementesh:*

- *Verifikimi i bazës së të dhënave për lejet për shfrytëzimin e ujërave*
- *Rishikimi i kushteve për shfrytëzim*
- *Njoftimi paraprak i mbajtësve të lejeve ujore*
- *Faturat për poseduesit e lejeve ujore*
- *Ndërmarrja e veprimeve zbatuese sipas nevojës.*

*Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ndërsa periudha kohore e zbatimit ishte 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Arkëtimi për pagesat ujore është rritur substancialisht në vitin 2021 kur janë arkëtuar të hyra në lartësi 1.5 milion EUR, krahasuar me vitin 2020 kur janë arkëtuar 0.6 milion EUR dhe sidomos krahasuar me vitin 2019 kur janë arkëtuar 0.2 milion EUR.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres substancial.

Veprimi 1.4.2: Ngritja e shkallës së pagesave për furnizimin me ujë.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim ka të bëjë me pagesat për furnizimin me ujë të pijshëm nga kompanitë publike (KRU-të). Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij veprimi përfshijnë:*

- *Paralajmërimi paraprak për mospagesë*
- *Dhënia e ndihmave për rastet sociale*

*Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve janë KRU-të ndërsa periudha kohore e zbatimit ishte 2017-2022.*

**b) Zbatimi**

- Shkalla e arkëtimit të faturave në nivel të sektorit është rritur në 96%.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres substancial.

Veprimi 1.4.3: Ngritja e shkallës së pagesave për ujitje.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim është paralel me atë për furnizimin me ujë të pijshëm të përshkruar mësipër. Si në rastin e furnizimit me ujë, ai përfshin aspektet vijuese:*

- *Paralajmërimi paraprak për mospagesë*
- *Fushata publicitare*
- *Veprime detyruese*

*Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve janë KU-të ndërsa periudha kohore e zbatimit ishte 2017-2022.*

**b) Zbatimi**

- Sipas të dhënave të raportuara nga KU "Radoniqi-Dukagjini" shkalla e arkëtimit të faturave është 90-98%, ndërsa te KU "Drini i Bardhë" shkalla e arkëtimit është 79%. KU "Ibër-Lepenci" nuk ka dërguar të dhëna.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

## MASA 1.5: Integrimi i sistemeve lokale dhe rurale të furnizimit me ujë në KRU

Në interes të arritjes së përmirësimit të efektivitetit të kostove dhe të sigurimit të qëndrueshmërisë financiare, operuesit e sistemeve rurale dhe komunale të furnizimit me ujë gradualisht duhet të integrohen në kuadër të ofruesve rajonal të furnizimit

me ujë për të qenë në gjendje të ofrojnë cilësi më të mirë të shërbimeve, menaxhim dhe kontroll më të mirë. Kjo çështje do të adresohet në dy faza që së pari përfshinë përgatitjen e planeve për integrim, dhe së dyti zbatimin e këtyre planeve.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.5:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 2 veprime si vijon:

Veprimi 1.5.1: Planet e veprimit për integrimin e sistemeve lokale dhe rurale.

**a) Planifikimi**

*Hartimi i planeve të veprimi të negociuar dhe dakorduar për integrimin e sistemeve komunale dhe lokale në Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit duke përfshirë masat transitore për të adresuar brengat e palëve kryesore të interesit. Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve janë KRU-të në bashkëpunim me komunat përkatëse.*

**b) Zbatimi**

- KRU-të nuk i kanë hartuar planet për integrimin e sistemeve komunale dhe rurale të ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Këshilli Ndërministror për Ujëra e ka hartuar dhe miratuar në vitin 2014 Strategjinë për Menaxhimin e Sistemeve Rurale të Ujësjellësit dhe Kanalizimit.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 1.5.2: Implementimi i planit i veprimit për integrimin e sisteme lokale dhe rurale.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Marrëveshje shërbimi*
- *Transferimi i aseteve dhe përgjegjësive operacionale*
- *Transferim i personelit*
- *Implementimi i masave mbështetëse transitore*

*Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve janë KRU-të ndërsa periudha kohore e zbatimit ishte 2015-2020.*

**b) Zbatimi**

- Janë integruar 184 fshatra.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

## MASA 1.6: Arritja e përputhshmërisë me Direktivën Evropiane për Ujë të Pijshëm

Kjo masë përfshinë veprimet për të adresuar cilësinë e ujit me të cilin furnizohen rrjetet e furnizimit (dalja nga impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm) dhe ujit të furnizuar tek konsumatorët. Masat që kanë të bëjnë me rrjetet e furnizimit me ujë të pijshëm janë specifikuar me poshtë dhe ato kontribuojnë në mënjanimin e kontaminimit të ujit në rrjet dhe në këtë mënyrë në arritjen e objektivave të kësaj mase. Këto aksione gjithashtu kontribuojnë në arritjen e objektivave të masave tjera duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me rrjedhjet nga rrjeti dhe besueshmërinë e furnizimit të rregullt me ujë.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.6:** PROGRES SUBSTANCIAL

Për këtë masë janë planifikuar 4 veprime si vijon:

Veprimi 1.6.1: Modernizimi i Laboratorëve të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit.

**a) Planifikimi**

*Modernizimi i laboratorëve të KRU-ve do të realizohet përmes aktiviteteve si në vijim:*

- *Renovimi i ndërtesave të laboratorëve (nëse ka nevojë)*
- *Sigurimi pajisjeve analitike të reja dhe zëvendësimi i atyre që janë të vjetruara*
- *Ndihma në implementim dhe trajnime*

Përgjegjës për modernizimin e laboratorëve të KRU-ve, sipas Strategjisë, është Ministria e Ekonomisë (realisht do të duhej të ishin KRU-të). Kostot e vlerësuara janë parallogaritur në 400,000 EUR ndërsa periudha kohore 2017-2019.

**b) Zbatimi**

- Dy prej shtatë KRU-ve i kanë laboratorët e akredituar, të tjerat i kanë laboratorët por janë në proces të akreditimit.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 1.6.2: Përmirësimi i impianteve të trajtimit të ujit të pijshëm.

**a) Planifikimi**

*Kjo masë përmban investimet në faza në secilën zonë të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit. Kjo përfshin një numër total prej 32 veprimeve. Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve janë KRU-të ndërsa periudha kohore e zbatimit ishte 2015-2020.*

**b) Zbatimi**

- Impiantet e burimeve të mëdha të 7 KRU-ve janë në gjendje të mirë. Për impiantet e sistemeve të vogla nuk ka të dhëna të konsoliduara.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 1.6.3: Përmirësimet në mbrojtjen e burimeve.

**a) Planifikimi**

*Ky aksion përfshin disa pika të renditura në bazën e të dhënave të projekteve investive. Kostot e tyre janë përmbledhur sipas zonave te shërbimeve të KRU-ve. Pasi që mbrojtja e burimeve ka rëndësi të madhe, investimet janë paraparë për programin e parë të veprimit. Përveç investimeve për mbrojtjen e burimeve, inspektimet dhe detyrimet për mbrojtjen e burimeve janë specifikuar më poshtë gjithashtu. Autoritet përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve janë MMPHI dhe KRU-të ndërsa periudha kohore e zbatimit ishte 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Është miratuar nga MMPHI Udhëzimi Administrativ për Zonat e Mbrojtura Sanitare të Burimeve në vitin 2017 dhe së fundmi është plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2022.
- Është miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2021 Udhëzimi Administrativ për Cilësinë e Ujit të Pijshëm me të cilin janë transpozuar direktivat relevante të BE-së.
- Është marrë vendimi nga MMPHI për ndalimin e transportit të materieve të rrezikshme në rrugën afër liqenit të Badovcit, por nuk vërehet zbatimi i vendimit.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres substancial.

Veprimi 1.6.4: Përmirësimi i performancës së rrjeteve ekzistuese të furnizimit.

**a) Planifikimi**

*Ky aksion ka të bëjë me renovimin e rrjeteve ekzistuese. Përveç arritjes së objektivit për sigurimin e cilësisë së ujit kjo masë ka të bëjë gjithashtu me arritjen e objektivave tjera:*

- *Përmirësimi i besueshmërisë së furnizimit për të siguruar furnizim 24 orësh*
- *Reduktimi i ujit të pa-faturuar.*

**b) Zbatimi**

- Shkalla e përputhshmërisë së mostrave të testuara për cilësinë e ujit të pijshëm që furnizohet nga sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU-të është mbi 98%.
- 94.4% të konsumatorëve marrin ujë 24 orë.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres substancial.

## MASA 1.7: Programi investues për sistemin e furnizimit me ujë

Ky program do të adresojë katër qëllime kryesore përmes veprimeve të radhitura më poshtë:

- *Renovimi i Sistemit* – adresimi i rasteve të mungesës së mirëmbajtjes në të kaluarën;
- *Ngritja e shkallës së mbulueshmërisë me sistem publik të ujësjellësit në 100% në zonat urbane*;
- *Ngritja e mbulueshmërisë me sistem publik të ujësjellësit në 90% në zonat rurale*;
- *Përmirësimi i trajtimit të ujërave për arritjen e përputhshmërisë me standardet e BE-së.*

Plani indikativ i rrjedhjes së investimeve është dhënë më poshtë.

| *Milion EUR* | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | *10-Vj.* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeveria** | 11.14 | 11.33 | 11.61 | 11.95 | 12.37 | 12.87 | 13.44 | 14.08 | 14.80 | 15.59 | **129.17** |
| **Donatorët** | 11.14 | 11.33 | 11.61 | 11.95 | 12.37 | 12.87 | 13.44 | 14.08 | 14.80 | 19.05 | **132.63** |
| **Gjithsej** | **22.27** | **22.66** | **23.21** | **23.90** | **24.74** | **25.73** | **26.88** | **28.17** | **29.60** | **34.64** | **261.80** |

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.7:** PROGRES SUBSTANCIAL

Treguesit e progresit:

- Janë investuar në total rreth 130 milion EUR si vijon:
  - Është zbatuar faza e VI-të e programit RWSSP për sistemet rurale në bashkëfinancim të Qeverisë së Kosovës me Qeverinë Zvicerane në vlerë 15.75 mil EUR.
  - Përmes KRU-ve (nga të hyrat vetanake dhe grantet) janë investuar 88.5 mil EUR.
  - Përmes komunave janë investuar rreth 20 mil EUR.
  - Përmes MMPHI (ndonëse përgjegjësi e ME) janë investuar rreth 5 mil EUR.

## MASA 1.8: Optimizimi i mbulueshmërisë me sistemin për ujitje

Kjo masë është adresuar në nivelin strategjik në Planin Zhvillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe është koherente me Masterplanin e Ujitjes të miratuar në vitin 2020. Një plan investues dhe një program për zhvillimin e bizneseve është i nevojshëm për të mbështetur Kompanitë e Ujitjes për të implementuar strategjinë.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.8:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 3 veprime si vijon:

Veprimi 1.8.1: Përgatitja e planeve zhvillimore të biznesit për kompanitë e ujitjes.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Analiza për implementimin e opsioneve strategjike për ujitje*
- *Plani afatgjatë zhvillimor dhe investiv*
- *Prioritetizimi*

*Përgjegjëse për zbatimin e këtij veprimi është MBPZHR dhe Kompanitë e Ujitjes përderisa periudha kohore kur është planifikuar zbatimi është 2017-2018.*

**b) Zbatimi**

- KU i hartojnë Planet e biznesit për periudhë 3-vjeçare.
- KU nuk hartojnë plane afatgjata zhvillimore dhe të investimeve.
- Në vitin 2020, KNU me propozim të MBPZHR ka miratuar Masterplanin e Ujitjes për periudhë 10 vjeçare.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres substancial.

Veprimi 1.8.2: Implementimi i planeve biznesore të zhvillimit të Kompanive të Ujitjes.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përcakton zbatimin e planeve të hartuara si pjesë e aksionit të mësipërm. Gjithashtu do të përfshijë investime të mëdha në riparimin e sistemeve të ujitjes. Institucione përgjegjëse për këtë veprim janë MBPZHR dhe KU-të gjatë periudhës 2018-2022.*

**b) Zbatimi**

- Faza e 2-të e projektit "Rehabilitimi dhe Modernizimi i Skemës së Ujitjes Radoniqi-Dukagjini".
- Investimet e parapara me Masterplanin e Ujitjes duhet të fillojnë të zbatohen në ndërkohë.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 1.8.3: Investimet në Sistemin e Ujitjes.

**a) Planifikimi**

*Detajet e sakta të investimeve që do të bëhen janë specifikuar në Strategjinë Për Ujitje të përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.*

*Vlerësimet indikative të kostos së investimeve janë dhënë në tabelën e mëposhtme.*

| *Milion EUR* | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | *10-Vj.* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeveria** | 1.81 | 1.84 | 1.89 | 1.95 | 2.01 | 2.09 | 2.19 | 2.29 | 2.41 | 2.54 | 21.03 |
| **Donatorët** | 1.81 | 1.84 | 1.89 | 1.95 | 2.01 | 2.09 | 2.19 | 2.29 | 2.41 | 3.10 | 21.59 |
| **Gjithsej** | 3.63 | 3.69 | 3.78 | 3.89 | 4.03 | 4.19 | 4.38 | 4.59 | 4.82 | 5.64 | 42.62 |

**b) Zbatimi**

- Faza e 2-të e projektit "Rehabilitimi dhe Modernizimi i Skemës së Ujitjes Radoniqi-Dukagjini".
- Investimet në sistemin e ujitjes që menaxhohet nga KU "Radoniqi-Dukagjini" kanë qenë rreth 3.2 milion EUR në periudhën 2021-2022.

- Investimet në sistemin e ujitjes që menaxhohet nga KU: Drini i Bardhë" kanë qenë 313,000 EUR gjatë periudhës 2017-2019.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

## MASA 1.9: Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujit nga shfrytëzuesit tjerë

Kjo masë ka të bëjë me shfrytëzimet tjera të ujit dhe qëndrueshmërinë e këtyre shfrytëzimeve (përpos furnizimit me ujë, ujitjes dhe industrisë).

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.9:** PA PROGRES

Për këtë masë janë planifikuar 4 veprime si vijon:

Veprimi 1.9.1: Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për turizëm dhe rekreacion.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshin:*

- *Analiza e opsioneve të implementimit për Strategjinë e Turizmit*
- *Plani zhvillimor afatgjatë*
- *Prioritetizimi*
- *Plani afatshkurtër i zhvillimit dhe investimeve*

*Përgjegjëse për zbatimin e këtij veprimi është MTI dhe MMPHI përderisa periudha kohore kur është planifikuar zbatimi është 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk është hartuar plani afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për turizëm dhe rekreacion. Këto do të trajtohen në kuadër të Planeve për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

Veprimi 1.9.2: Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për ferma të peshqve.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përcakton hartimin e planit afatgjatë për shfrytëzim të ujit për ferma të peshqve dhe përfshin veprimet si vijon:*

- *Analiza e opsioneve të implementimit të Planeve Zhvillimore për Bujqësi dhe Zona Rurale*
- *Hulumtimi i tregut*
- *Analiza e opsioneve*
- *Plani Zhvillimor Afatgjatë*
- *Prioritetizimi*
- *Plani afatshkurtër i zhvillimit dhe investimeve*

*Institucione përgjegjëse për këtë veprim janë MBPZHR dhe MMPHI gjatë periudhës 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk është hartuar plani afatgjatë për shfrytëzim të ujit për ferma të peshqve. Kjo do të duhet të trajtohet në PMPL.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

Veprimi 1.9.3: Përgatitja e një strategjie për shfrytëzimin e qëndrueshëm të inerteve nga pellgjet lumore.

**a) Planifikimi**

*Nxjerrja e pakontrolluar e inerteve nga shtretërit e lumenjve ka shkaktuar dëme të mëdha. Kostot e riparimeve të dëmeve të tilla janë të mëdha. Si përgjigje për këtë problem nxjerrja e inerteve nga shtretërit e lumenjve ishte ndaluar me vendim të Qeverisë. Megjithatë, një ndalim i tillë mund të shkaktojë humbje potenciale të përfitimeve ekonomike. Për këtë arsye është vlerësuar se një strategji qendrore për shfrytëzim të qëndrueshëm të inerteve do të duhej të arrinte një balancim në mes të këtyre dy ekstremeve.*

*Ky veprim përcakton hartimin e një strategjie për shfrytëzim të inerteve që do të përmbante elementet si vijon:*

- *Hulumtimi i resurseve potenciale*
- *Analiza e ndikimit të nxjerrjes së inerteve dhe masat e mundshme lehtësuese*
- *Përgatitja e planit afatgjatë*
- *Kontrata afatshkurta për koncesione*

*Institucione përgjegjëse për këtë veprim janë MZHE dhe MMPHI gjatë periudhës 2017-2018.*

**b) Zbatimi**

- Nuk është hartuar strategjia për shfrytëzim të qëndrueshëm të inerteve.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

Veprimi 1.9.4: Dhënia e lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale duke respektuar nevojat dhe të drejtat e shfrytëzuesve që gjenden në rrjedhën e poshtme.

**a) Planifikimi**

*Zhvillimi dhe shfrytëzimi i kapaciteteve për gjenerimin e rrymës elektrike nga hidrocentralet është temë kryesore në strategjinë e energjisë së Kosovës pasi që kontribuon në disa objektiva kryesore: (i) Përmbushja e nevojave vetanake, (ii) Rritja e kapacitetit për të plotësuar nevojat e pikut (ulja e importit), (iii) Burim i ripërtrishëm i energjisë (ulja e emisioneve)*

*Ky veprim përmban elementet vijuese:*

- *Rishikimi i lejeve ekzistuese për hidrocentrale, me qëllim të optimizmit të (multi-) funksionalitetit*
- *Përgatitja e politikave për lejet për hidrocentrale të reja*
- *Integrimi me planet për menaxhimin e pellgjeve lumore*

*Institucion përgjegjës për këtë veprim është MMPHI gjatë periudhës 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- MMPHI ka krijuar një grup punues për rishikimin e procesit të lëshimit të lejeve ujore për hidrocentrale i cili grup punues në qershor të vitit 2021 ka hartuar një raport me rekomandime për këtë problematikë.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i vogël.

## MASA 1.10: Plani për menaxhimin e thatësirave

Edhe pse kjo masë është specifikuar ndaras këtu, aksionet e nevojshme dhe masat në përgjithësi duhet të harmonizohen me planet për menaxhimin e pellgjeve lumore dhe planet për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet.

Ashtu si në rastin e mbrojtjes nga vërshimet të përshkruar në objektivin strategjik për mbrojtje nga ujërat, mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave është parakushti kryesor. Një parakusht tjetër për këtë masë është aplikimi efikas i sistemit të lejeve ujore, monitorimi i përmbushjes së obligimeve të përcaktuara, me ligj, për licencimin.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 1.10:** PROGRES i PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 3 veprime si vijon:

Veprimi 1.10.1: Masat ligjore dhe institucionale për menaxhimin e thatësirave.

**a) Planifikimi**

*Ky aksion përmban disa elemente duke përfshirë:*

- *Zgjedhjen e Koordinatorit Nacional për Thatësira*
- *Zgjedhjen e Komitetit për Emergjencat nga Thatësirat*
- *Udhëzimin Administrativ për Monitorimin dhe Menaxhimin e Thatësirave*
- *Bashkimin dhe kontributin në Qendrën për Menaxhimin e Thatësirave në Evropën Juglindore*

*Përgjegjëse për zbatimin e këtij veprimi është MMPHI përderisa periudha kohore kur është planifikuar zbatimi është 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk janë ndërmarrë veprimet e planifikuara, pos që së fundmi IHMK ka filluar të bashkëpunojë dhe kontribuojë në qendrën për menaxhimin e thatësirave në Evropën Juglindore.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i vogël.

Veprimi 1.10.2: Planet e Menaxhimit të Thatësirave.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përcakton hartimin e planeve të menaxhimit të thatësirave dhe përfshin veprimet si vijon:*

- *Përgatitja e formës standarde për Planin e Menaxhimit të Thatësirave për KRU*
- *Llogaritja e statistikave për Prurje të Ulëta për të gjitha pellgjet lumore*
- *Llogaritja dhe përshkrimi i Indeksit të Shfrytëzimit të Ujit (ISHU) sezonale për të gjitha pellgjet lumore*
- *Llogaritja dhe raportimi i Indeksit Standard të Reshjeve (ISR) mujore për të gjitha pellgjet lumore*
- *Përgatitja e Grafikut të Operimit të Akumulacioneve*
- *Përgatitja e regjistrit dhe hartave të burimeve kryesore të furnizimit (normal + emergjencë)*
- *Ofrimi i trajnimit dhe mbështetjes për përgatitjen e Planeve për Thatësira*
- *Publikimi i Planeve Rajonale për Thatësira*

*Institucione përgjegjëse për këtë veprim janë MMPHI dhe KRU-të gjatë periudhës 2018-2021.*

**b) Zbatimi**

- KRU-të i kanë hartuar në vitin 2018 Planet e Menaxhimit të thatësirave duke u bazuar në ISR.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres substancial.

Veprimi 1.10.3: Sistemi i Paralajmërimit të Thatësirave.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përcakton:*

- *Përgatitjen e një sistemi shtetëror të paralajmërimit të thatësirave i bazuar në Indeksin e Furnizimit të Ujit Sipërfaqësor (angl. 'Surface Water Supply Index').*
- *Monitorimi i situatës së thatësisë dhe publikimi i paralajmërimeve.*

*Institucione përgjegjëse për këtë veprim janë MMPHI dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës gjatë periudhës 2017-2018.*

**b) Zbatimi**

- IHMK ka një sistem të monitorimit të thatësisë dhe paralajmërimit bazuar në ISR.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i pjesshëm.

## 4.2 Progresi kundrejt Objektivit Strategjik 2:

*"Të rregullohen dhe mbikëqyren aktivitetet që rrisin presionin në mjedisin ujor në mënyrë proporcionale, efiçiente dhe efektive, në mënyrë që të arrihen objektiva mjedisore të arsyetuara nga aspekti ekonomik për trupat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore duke respektuar njëkohësisht parimet e menaxhimit të qëndrueshëm."*

Për zbatimin e këtij objektivi strategjik me Strategji janë planifikuar *8 masa* si vijon:

### MASA 2.1: Kontrollimi i shkarkimeve ndotëse

Me dispozitat e Ligjit për Ujëra për shkarkimin e ujërave të ndotura kërkohet leje ujore. Këto dispozita duhet të zbatohen në praktikë në mënyrë që të arrihet përputhshmëria me ligjin. Kjo masë do të koordinohet me fushatën për zbatimin e rregullave për shfrytëzimin e ujërave. Si në rastin e kontrollimit të shfrytëzimit të ujit, lejet ujore do të lëshohen në pajtim me *Manualin për Lejet Ujore* (i vitit 2007) dhe do të përdorë Sistemin e Vlerësimit dhe Planifikimit të Ujërave.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 2.1:** PROGRES I VOGËL

Për këtë masë janë planifikuar 4 veprime si vijon:

Veprimi 2.1.1: Fushata për zbatimin e rregullave për shkarkimin e ujërave.

**a) Planifikimi**

*Fushata duhet të përfshijë:*

- *Identifikimi i shkarkimeve të pa-autorizuara të ujërave*
- *Lëshimi i vendimit për ndalimin e shkarkuesve të pa-autorizuar të ujit dhe kërkimi nga ata që të aplikojnë për marrjen e lejes ose të ndërprejnë shkarkimin e mëtutjeshëm të ujit*
- *Lëshimi i licencës së re*
- *Aksioni kundër moszbatimit në vazhdimësi të lejeve për shkarkimin e ujërave*
- *Detyrimi i zbatimit të kushteve të përshkruara në leje*

*Autoritet përgjegjës ishte përcaktuar MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019 .*

**b) Zbatimi**

- Nuk është zhvilluar një fushatë e përgjithshme dhe e strukturuar.
- Inspektorati ka zhvilluar aktivitet të inspektimit dhe ka lëshuar 287 vendime.

**c) Progresi**

Progres i vogël.

Veprimi 2.1.2: Lejet për shkarkime të drejtpërdrejta nga impiantet e mëdha industriale.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshin elementet si vijon:*

- *Regjistri i impianteve të mëdha*
- *Karakteristikat e shkarkimeve*
- *Aplikimi dhe procedimi i lejeve*

*Autoritet përgjegjës ishte përcaktuar MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

MMPHI nuk e ka krijuar ende një regjistër të plotë të shkarkimeve të ujërave të ndotura në trupat ujorë nga objektet e mëdha industriale me karakteristikat e shkarkimeve. Prej 6 subjekteve të mëdha industriale, 3 nuk kanë leje, 2 kanë leje të integruar dhe vetëm 1 ka leje ujore:

- Trepça – SH.A Nuk ka leje
- New Co – Ferronikeli Ka leje të integruar
- KEK - SH.A Ka aplikuar për leje ujore
- Sharrcem - SH.P.K Ka leje të integruar
- F.P.K - Deve Ka leje ujore
- Birra Peja – SH.A Ka aplikuar.

**c) Progresi**

Progres i vogël.

Veprimi 2.1.3: Lejet për Shkarkuesit Indirekt.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë elementet si vijon:*

- *Regjistri i shkarkuesve në kanalizimet urbane*
- *Karakteristikat e shkarkimeve*
- *Aplikimi dhe procedimi i licencave*

*Autoritetet përgjegjëse ishin përcaktuar KRU-të dhe MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019 .*

**b) Zbatimi**

Nuk ka informacion nëse KRU-të i kanë kompletuar regjistrat për shkarkimet e ujërave të ndotura industriale në kanalizimin publik.

**c) Progresi**

Pa progres.

Veprimi 2.1.4: Programi i Vlerësimit të Lejeve për Shkarkimin e Ujërave.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë elementet si vijon:*

- *Verifikimi dhe validimi i modelit SVPU të shkarkimit të ujërave të ndotura për secilin pellg lumor duke përdorur të dhënat e përditësuara nga të dhënat e monitorimit*
- *Ri-vlerësimi i ndikimit të shkarkimeve individuale*
- *Prioritetizimit i shkarkimeve*
- *Negocimi me ndotësit për zvogëlimin e mundshëm të ndotjes në periudhat e ardhshme planifikuese*

- *Vendosja e kërkesave për përmirësime të arritshme*
- *Lëshimi i lejeve të rishikuara*

*Autoritet përgjegjës ishte përcaktuar MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2019-2022.*

**b) Zbatimi**

Nuk janë zhvilluar aktivitete e përmendura.

**c) Progresi**

Pa progres.

## MASA 2.2: Të zgjerohet mbulueshmëria me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura

Kjo masë përfshin investime të mëdha në sistemin e grumbullimin e ujërave të ndotura. Këto investime do të sigurojnë pajtueshmëri me kërkesat e DTUNU për mbulimin me sistem të tillë hap pas hapi deri në vitin 2035.

Sikurse edhe investimet për zgjerimin e mbulueshmërisë së furnizimit me ujë, edhe këto investime janë përfshirë në bazën e të dhënave të projekteve investive. Kjo përbëhet nga 32 veprime që paraqesin 4 faza të investimeve në secilën nga 8 zonat rajonale.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 2.2:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë **nuk** janë planifikuar veprime specifike.

Treguesit e progresit në zbatimin e kësaj mase:

- Mbulueshmëria me sisteme publike të grumbullimit të ujërave të ndotura ka arritur në 75% të popullsisë – prej tyre 65% menaxhohen nga KRU-të (në zonat urbane 97% ndërsa në zonat rurale 46%)
- Në periudhën 2018-2020 janë zbatuar 8 projekte përmes MMPHI (ndonëse përgjegjësi e ME apo më e drejtë e vet KRU-ve) me të cilat janë ndërtuar sistemet e kanalizimit për 30 fshatra.

## MASA 2.3: Përmirësimi dhe ruajtja e funksionalitetit të sistemeve ekzistuese të grumbullimit të ujërave të ndotura

Kjo masë ka të bëjë me investime të mëdha në sistemin e mbledhjes së ujërave të ndotura. Këto investime do të sigurojnë pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Ujëra dhe me Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane për mbulim me sistem të tillë. Megjithatë, në këtë instancë investimet kërkojnë vëmendje të mëtutjeshme – mbledhjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëse kanalizimet ekzistuese "të kombinuara" duhet të zëvendësohen me sisteme të ndara, kjo e fundit duke qenë e preferuar në shumë aspekte, por është më e kushtueshme për t'u implementuar.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 2.3:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë **nuk** janë planifikuar veprime specifike.

Treguesit e progresit në zbatimin e kësaj mase:

- Janë zbatuar projektet e mbështetura nga KfW në Prizren, Pejë dhe Gjakovë në vlerë totale 17.5 mil. EUR;
- Është kompletuar studimi i fizibilitetit për sistemin e kanalizimit të rajonit të Prishtinës mbështetur nga KfW.
- Është në përgatitje projekti për përmirësimin e sistemit të kanalizimit në rajonin e Prishtinës (komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë) mbështetur nga KfW në vlerë rreth 70 milion EUR.

## MASA 2.4: Implementimi i trajtimit të ujërave të ndotura

Kjo masë ka të bëjë me sigurimin e trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane siç kërkohet në Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (91/271/EEC). Objektivi i ndërlidhur me këtë masë është:

- Hyrja në operim në përputhshmëri të plotë me kërkesat bazë të DTUNU hap pas hapi deri në vitin 2036, ku prioritet do t'u jepet ndërtimit të impianteve që realizojnë përfitimet me të mëdha për shfrytëzuesit e ujit poshtë rrjedhës.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 2.4:** PROGRES SUBSTANCIAL

Për këtë masë **nuk** janë planifikuar veprime specifike.

Treguesit e progresit në zbatimin e kësaj mase:

- Përqindja e ujërave të ndotura që trajtohen është rritur nga 1% në 11%.
- Janë finalizuar dhe janë lëshuar në funksion impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Junikun, Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën.
- Janë në fazën e planifikimit dhe projektimit impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Prishtinën (së bashku me Obliqin, Fushë Kosovën dhe Graçanicën), Gjilanin dhe Mitrovicën (së bashku me Vushtrrinë). Këto impiante planifikohet të kompletohen deri në vitin 2026.
- Është ndërtuar impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në fshatin Orllan me qëllim të mbrojtjes së akumulimit të Batllavës.

## MASA 2.5: Implementimi i trajtimit të ujërave të ndotura

Kjo masë ka të bëjë me investimet që duhet të realizohen për 3 masat e mësipërme (2.2, 2.3, 2.4). Për zbatimin e kësaj mase duhet pasur parasysh se ka kufizime të mëdha jo vetëm të fondeve investuese por edhe në aftësinë për të mbuluar kostot e operimit dhe mirëmbajtjes së impianteve.

Vështirësitë që kanë KRU-të në mbledhjen e të ardhurave për shërbimet ekzistuese sipas të gjitha gjasave do të rriteshin kur të ngritën tarifat për shërbimet e kanalizimit, rritje kjo që do të nevojitej për mbulimin e kostove të operimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura. Prandaj është propozuar një qasje e kujdesshme për investimet në trajtimin e ujërave të ndotura.

Një alokim indikativ i fondeve investuese për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura është dhënë në tabelën e më poshtme.

| *Milion EUR* | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | *10-Vj.* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeveria** | 4.40 | 4.48 | 4.59 | 4.72 | 4.89 | 5.09 | 5.31 | 5.57 | 5.85 | 6.16 | **51.07** |
| **Donatorët** | 4.40 | 4.48 | 4.59 | 4.72 | 4.89 | 5.09 | 5.31 | 5.57 | 5.85 | 7.53 | **52.44** |
| **Gjithsej** | 8.80 | 8.96 | 9.18 | 9.45 | 9.78 | 10.17 | 10.63 | 11.14 | 11.70 | 13.69 | **103.50** |

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 2.5:** PROGRES SUBSTANCIAL

Për këtë masë **nuk** janë planifikuar veprime specifike.

Treguesit e progresit në zbatimin e kësaj mase:

- Janë kryer investime në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në vlerë mbi 60 milion EUR (ITUN për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën), pra më shumë se vlera e planifikuar me Strategji.
- Janë zgjidhur modalitetet e investimit për implementimin e investimeve në trajtimin e ujërave të ndotura në vlerë rreth 150 mil. EUR (ITUN për Prishtinën, Mitrovicën dhe Gjilanin).

## MASA 2.6: Plani për menaxhimin e thatësirave

Kjo masë parasheh që të sigurohet trajtim i duhur dhe ripërdorim i llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura me theks të veçantë në gjenerimin e energjisë për impiantet e mëdha dhe përgatitja për përdorim të dobishëm në bujqësi për impiantet e vogla

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 2.6:** PROGRES I VOGËL

Për këtë masë janë planifikuar 2 veprime si vijon:

Veprimi 2.6.1: Përgatitja e strategjisë shtetërore për menaxhimin dhe largimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura.

**a) Planifikimi**

*Menaxhimi i llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura do të jetë një çështje me rëndësi kur të implementohet programi i investimeve për trajtimin e ujërave të ndotura. Prandaj është vendimtare që plani për menaxhimin e këtyre mbetjeve të përgatitet paraprakisht. Strategjia e menaxhimit të këtyre mbetjeve nevojitet të zhvillohet.*

*Ky veprim përmban disa elemente duke përfshirë:*

- *Vlerësimi i parashikimit të llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura*
- *Identifikimi i opsioneve, përgatitja, optimizimi*
- *Përcaktimi i opsionit të preferuar*
- *Udhëzimi Administrativ - adoptimi*

*Përgjegjëse për zbatimin e këtij veprimi është MMPHI përderisa periudha kohore kur është planifikuar zbatimi është 2020-2021.*

**b) Zbatimi**

- Nuk është hartuar Strategji shtetërore për menaxhimin e llumit të kanalizimit.
- Është iniciuar hartimi i planeve për menaxhimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura me vendim të Këshillit Ndërministror për Ujëra – Operatorët e impianteve të ujërave të ndotura (KRU-të) duhet t`i hartojnë ato deri në fund të vitit 2022.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i vogël.

Veprimi 2.6.2: Investimet që kanë të bëjnë me strategjinë e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura.

**a) Planifikimi**

*Investimet që kanë të bëjnë me strategjinë e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura duhet të integrohen në bazën e të dhënave për projektet investive.*

**b) Zbatimi**

- Pasi që nuk është hartuar Strategjia për Menaxhimin e Llumit, nuk janë zbatuar as investime që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj strategjie.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

## MASA 2.7 Menaxhimi i ndotjes difuzive nga bujqësia

Duke pasur parasysh faktin se është e njohur që aktivitetet bujqësore, siç janë: përdorimi i plehrave dhe agro-kimikateve tjera (p.sh. biocidet), mund të shkaktojnë ndotje difuzive të ujërave përmes kullimit dhe infiltrimit të ujit të kontaminuar, kjo masë dhe veprimet e përfshira në të duhet të koordinohen me politikat agro-mjedisore. Kjo është reflektuar në Direktivën Kornizë Ujërave (2000/60/EC) dhe në Direktivën e Nitrateve (91/676/EEC). Edhe pse në Kosovë niveli i aktiviteteve bujqësore është

ende relativisht i ulët, duhet të miratohen rregullore që të arrihet një ekuilibër në mes të përdorimit të agro-kimikateve dhe të parandalimit të ndotjes difuzive.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 2.7:** PA PROGRES

Për këtë masë janë planifikuar 2 veprime si vijon:

Veprimi 2.7.1: Udhëzues për prodhuesit bujqësorë – përdorimi i plehrave.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshin:*

- *Përgatitja dhe Shpërndarja e Udhëzuesve*
- *Mbështetje me shërbime shtesë*

*Përgjegjëse për zbatimin e këtij veprimi është MBPZHR përderisa periudha kohore kur është planifikuar zbatimi është 2020-2021.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka pasur asnjë progres: nuk ka informacion nëse janë hartuar udhëzimet për përdorimin e plehrave në bujqësi.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

Veprimi 2.7.2: Udhëzimet për Prodhuesit Bujqësorë – Përdorimi i Biocideve.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Përgatitja dhe Shpërndarja e Udhëzuesve*
- *Mbështetje me shërbime shtesë*

*Përgjegjëse për zbatimin e këtij veprimi është MBPZHR përderisa periudha kohore kur është planifikuar zbatimi është 2019-2020.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka progres – nuk ka informacion nëse janë hartuar udhëzimet për përdorimin e biocideve nga MBPZHR.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

## MASA 2.8: Ulja e ndotjeve difuzive nga burimet jo-bujqësore[2]

Ndotjet difuzive që vijnë si pasojë e burimeve jo-bujqësore duhet gjithashtu të konsiderohen duke përfshirë ndotjet difuzive që vijnë nga burimet tjera, siç janë: deponimi i mbeturinave të kontaminuara, minierat dhe aktivitetet e kaluara industriale.

Shumë nga aktivitetet që vijnë si pasojë e kontaminimit të tokave nga aktivitetet industriale do të kërkojnë përpjekje të konsiderueshme për rehabilitimin e tyre. Megjithatë, ekzistojnë masa që do të mund të merreshin për të zvogëluar kontaminimin e vazhdueshëm të ujërave: deponimi i mbeturinave të ngurta komunale është një brengë e madhe për këtë regjion. Prandaj qasja në dy faza është ndërmarrë ku kërkohen aksione të menjëhershme për zvogëlimin e problemeve që vijnë si pasojë e deponimit të mbeturinave të ngurta komunale, dhe qasja afatgjatë është adoptuar për sipërfaqet e mëdha të tokave të kontaminuara.

---

[2] Shënim: Vlerësohet se veprimet e tilla me ndikim anësor në ujëra do të duhej të ishin në strategji sektoriale dhe jo të ujërave – kurse në këtë të ujërave vetëm të cekën koordinimet me strategji të tilla.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 2.8:** PA PROGRES

Për këtë masë janë planifikuar 2 veprime si vijon:

Veprimi 2.8.1: Regjistri i tokave të kontaminuara.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë hartimin e një regjistri për tokat e kontaminuara. Kjo ishte planifikuar të bëhet përmes aktiviteteve vijuese:*

- *Identifikimi i zonave me toka të kontaminuara*
- *Karakterizimi i shkurtër*
- *Përgatitja e hartave*
- *Publikimet*

*Përgjegjëse për zbatimin e këtij veprimi është MMPHI përderisa periudha kohore kur është planifikuar zbatimi është 2018-2021.*

**b) Zbatimi**

- Nuk është hartuar regjistri i tokave të kontaminuara dhe rrjedhimisht nuk dihet sipërfaqja e tokave të kontaminuara sipas klasifikimeve.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

Veprimi 2.8.2: Plani dhe Strategjia për Rehabilitimin e Tokave të Kontaminuara

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Përgatitja e regjistrit të tokave të kontaminuara*
- *Vlerësimi i rrezikut*
- *Përgatitja e opsioneve për rehabilitim*
- *Prioritetizimi*
- *Strategjia afatgjate*
- *Plani i Veprimit afatshkurtër*

Përgjegjës për zbatimin e këtij veprimi është MMPHI (tash MMPHI) përgjatë periudhës kohore 2020-2022.

**b) Zbatimi**

- Nuk ka një plan e as strategji për rehabilitimin e tokave të kontaminuara.

**c) Vlerësimi i progresit**

Pa progres.

Veprimi 2.8.3: Përcaktimi i lokacioneve për deponimin e mbeturinave komunale

**a) Planifikimi**

*Ky veprim ka të bëj me përcaktimin në të gjitha komunat të lokacioneve për deponimin e mbeturinave komunale për përdorim nga banorët dhe bizneset lokale.*

*Autoritetet me përgjegjësi të drejtpërdrejt të zbatimit të këtij veprimi janë komunat dhe MMPHI (tash MMPHI) përgjatë periudhës kohore 2020-2022.*

**b) Zbatimi**

- Sipas Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave 2021-2030, aktualisht në Kosovë mblidhen mbeturinat për më pak se 70% të popullatës.

**c) Vlerësimi i progresit**

Progres i vogël

## 4.3 Progresi kundrejt Objektivit Strategjik 3:

*"Të arrihen nivele të pranueshme të mbrojtjes së popullsisë dhe pronës nga efektet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë vërshimet, rrëketë dhe erozionin në një mënyrë që është ekonomikisht e ekuilibruar dhe me kosto efektive."*

Për zbatimin e këtij objektivi strategjik me Strategji janë planifikuar *5 masa* si vijon:

### MASA 3.1: Kontrollimi i shkarkimeve ndotëse

Me këtë masë kërkohet kompletimi i legjislacionit sekondar të parapararë në kapitullin VIII-të të Ligjit për Ujëra.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 3.1:** PROGRES I VOGËL

Për këtë masë janë planifikuar 4 veprime si vijon:

Veprimi 3.1.1: Krijimi i një sistemi të mbledhjes, verifikimit dhe publikimit të të dhënave

**a) Planifikimi**

*Ky veprim është parakusht për përgatitjen e hartave të përditësuara për rrezikun nga vërshimet dhe analizave të rrezikut. Gjithashtu, ky veprim është esencial për zbatimin e masave shumë të nevojshme për paralajmërimin e vërshimeve. Ky veprim është mbështetur nga projekti i GIZ.*

*Veprimi përfshin:*

- *Kompletimin e të dhënave historike për vërshimet duke përfshirë vjetarët statistikorë të IHMK, shënimet komunale, dëshmitë e banorëve lokal;*
- *Instalimin e pajisjeve automatike për matjen e reshjeve me telemetri në lokacionet ekzistuese dhe në të gjitha kompanitë e ujit;*
- *Instalimin e stacioneve për matjen e rrjedhave dhe përgatitjen e grafikoneve krahasuese për të gjitha stacionet;*
- *Sistemet monitoruese për akumulacionet (nivelet);*
- *Sistemin e menaxhimit të të dhënave për reshjet, të dhënat për prurjen dhe nivelet e ujërave duke përfshirë ruajtjen e këtyre të dhënavedhe publikimin e tyre;*
- *Rrjetet e monitorimit të ujërave nëntokësore;*
- *Monitorimin e borës – instrumentet për matjen e nivelit të dëborës në lartësi të mëdha*

*Autoritet përgjegjës është përcaktuar IHMK dhe MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- IHMK e ka një sistem të mbledhjes, verifikimit dhe publikimit të të dhënave për stacionet meteorologjike dhe hidrologjike i cili është në proces të kompletimit dhe zhvillimit të mëtutjeshëm.

**c) Progresi**

Progres i pjesshëm

Veprimi 3.1.2: Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë elementet si vijon:*

- *Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet në pajtim me kërkesat e Direktivës për Vërshimet duke përfshirë:*
- *Përgatitjen e udhëzimeve standarde për Planet Shtetërore të Rreziku nga Vërshimet*
- *Përgatitjen e udhëzimeve standarde për hulumtimin e rrafsheve të përmbytura;*
- *Hulumtimin topografik të kanaleve të lumenjve;*
- *Përgatitjen e modeleve hidraulike të lumenjve me ISIS apo HEC-RAS;*
- *Hartat e rrezikut nga vërshimet;*
- *Hartat e kërcënimit nga vërshimet;*
- *Vlerësimin e dëmeve të rrezikut nga vërshimet;*
- *Identifikimin dhe vlerësimin e opsioneve;*
- *Planet Menaxhuese dhe Prioritetet Investive për Rrezikun nga Vërshimet.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI dhe IHMK përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019, ndërsa kostot e këtij veprimi janë vlerësuar në 2,000,000 EUR.*

**b) Zbatimi**

- Në vitin 2021 është filluar projekti për përgatitjen e hartave të rrezikut nga përmbytjet për të gjitha pellgjet lumore të Kosovës, të cilat janë kompletuar në vitin 2022. Vlera e projektit 2.5 mil. EUR.
- Në vitin 2020 është kryer vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet, projekt i financuar nga donatorët në vlerë 0.6 mil. EUR.
- Planet e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet nuk janë kompletuar ende (sipas Strategjisë është dashur të kompletohen në vitin 2019).

**c) Progresi**

Progres i vogël.

Veprimi 3.1.3: Zbatimi i Planeve për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë elementet si vijon:*

- *Dizajnimi i masave për mbrojtje nga vërshimet*
- *Përgatitja e dokumenteve të tenderit*
- *Asistenca në tenderim: identifikimin dhe vlerësimin e opsioneve;*
- *Planet Menaxhuese dhe Prioritetet Investive për Rrezikun nga Vërshimet.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI dhe IHMK përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019, ndërsa kostot e këtij veprimi janë vlerësuar në 2,000,000 EUR.*

**b) Zbatimi**

- Planet nuk janë zbatuar, pasi që ato nuk janë hartuar ende.

**c) Progresi**

Pa progres

Veprimi 3.1.4: Sistemi menaxhues dhe mirëmbajtja e infrastrukturës për parandalimin e vërshimeve

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë elementet si vijon:*

- *Kompletimin e regjistrit (inventarizimin) e infrastrukturës*

- *Procedurat e mirëmbajtjes së regjistrave*
- *Programi i inspektimit të infrastrukturës*
- *Programi i mirëmbajtjes së infrastrukturës.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI dhe komunat përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2018-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka inventarizim e as sistem të inspektimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës për mbrojtje nga vërshimet.

**c) Progresi**

Pa progres

## MASA 3.2: Paralajmërimi i vërshimeve dhe menaxhimi i emergjencave

Ngjashëm si me masat tjera të këtij Objektivi Strategjik, potenciali për dëme nga vërshimet mbetet si mundësi. Prandaj është e nevojshme që të krijohet dhe të zbatohet një sistem i parandalimit të vërshimeve dhe reagimit në rast të emergjencave. Kjo e fundit veçse ekziston, mirëpo avancime të mëtutjeshme janë të nevojshme për paralajmërimin e vërshimeve.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 3.2:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 2 veprime si vijon:

Veprimi 3.2.1: Sistemi i monitorimit dhe paralajmërimit të rrezikut nga vërshimet

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Përgatitja e sistemit shtetëror për paralajmërimin e vërshimeve të bazuar në ISR*
- *Monitorimi i sistemit rajonal të paralajmërimit për vërshime bazuar në MeteoAlarm*
- *Monitorimi i statusit të vërshimeve dhe lëshimi i paralajmërimeve sipas nevojës*
- *Regjistrimi në forumin EFAS dhe monitorimi në baza të rregullta*

*Autoritet përgjegjës është përcaktuar IHMK dhe MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2018-2019.*

**b) Zbatimi**

- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës e ka krijuar sistemin e paralajmërimit të hershëm të përmbytjeve përmes SPI. Ky sistem duhet të avancohet dhe të lidhet me MeteoAlarm.
- IHMK është regjistruar në EFAS dhe bën monitorim në baza të rregullta.

**c) Progresi**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 3.2.2: Menaxhimi i emergjencave të vërshimeve.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Procedurat në rast emergjence*
- *Prokurimi i pajisjeve*
- *Trajnimi*

*Autoritet përgjegjës është përcaktuar MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2018-2019.*

**b) Zbatimi**

- Procedurat për veprim në rast të vërshimeve janë përcaktuar me *UA nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave*.

**c) Progresi**

Progres i pjesshëm.

## MASA 3.3: Infrastruktura për parandalimin dhe mbrojtjen nga vërshimet

Qëllimi i kësaj mase është që të sigurohet implementimi i investimeve për parandalimin e rrezikut nga vërshimet duke përfshirë rehabilitimin e strukturave ekzistuese për mbrojtjen nga vërshimet.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 3.3:** PROGRES I VOGËL

Për këtë masë janë planifikuar 3 veprime si vijon:

Veprimi 3.3.1: Investimet në Infrastrukturën për Mbrojtje nga Vërshimet – Faza 1

**a) Planifikimi**

*Politika e përvetësuar në këtë strategji është që ngadalë të lëvizet drejt ndarjes së sistemit të kanalizimit të ujërave të ndotura prej atij atmosferik (drenazhit) kudo që është praktike dhe e përballueshme.*

*Qasja e ndërmarrë është:*

- *Implementimi i sistemeve të ndara për të gjitha zonat e reja (dhe zonat në të cilat nuk ka një sistem të tillë);*
- *Transformimi gradual gjatë procesit të renovimit dhe zëvendësimit të sistemeve ekzistuese nga ato të kombinuara në të ndara, përveç në rastet ku transformimi i tillë është shumë i shtrenjtë ose teknikisht jopraktik;*
- *Aplikimi i sistemeve të qëndrueshme urbane të drenazhimit (SQUD) kudo që është e përshtatshme dhe e aplikueshme, në veçanti në zonat e reja zhvillimore dhe gjatë renovimit të sistemeve ekzistuese*

*Ky veprim përfshinë:*

- *Udhëzimet për komunat*
- *Planet rregullative urbane për komunat*
- *Planet komunale për drenazhet urbane*

*Autoritet përgjegjës është përcaktuar MMPHI dhe komunat, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Gjatë vitit 2017-2021 janë realizuar 33 projekte infrastrukturore për rregullimin e lumenjve në funksion të parandalimit të vërshimeve.

**c) Progresi**

Progres substancial.

Veprimi 3.3.2: Sistemi i Drenazhimit Urban

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Udhëzimet për komunat*
- *Planet rregullative urbane për komunat*
- *Planet komunale për drenazhet urbane*

*Autoritete me përgjegjësi të drejtpërdrejt janë komunat, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2019-2026.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka informacion nëse ndonjëra prej komunave ka plan për drenazhimin urban – sistemin e kanalizimit atmosferik.

**c) Progresi**

Pa progres.

Veprimi 3.3.3: Investimet në infrastrukturën për mbrojtje nga vërshimet – Faza 2

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë implementimin e masave të investimeve të reja prioritare siç janë përcaktuar në Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet.*

*Autoritete me përgjegjësi të drejtpërdrejt janë MMPHI dhe komunat, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2019-2026.*

**b) Zbatimi**

- Meqenëse Plani i Menaxhimit të Vërshimeve nuk është hartuar ende, ky veprim nuk ka mundur të zbatohet.

**c) Progresi**

Pa progres

## MASA 3.4: Sigurimi që të gjitha strukturat ekzistuese akumuluese janë të sigurta

Kjo masë është e ndërlidhur me masën që ka të bëjë me inspektimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës për parandalimin e vërshimeve. Megjithatë, pasi që digat dhe akumulimet kanë disa funksione, jo vetëm parandalimin e vërshimeve, dhe janë struktura të mëdha, një masë specifike është përfshirë këtu.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 3.4:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 2 veprime si vijon:

Veprimi 3.4.1: Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Digave

**a) Planifikimi**

*Qëllimi i këtij veprimi është që të vendoset një vlerësim i vazhdueshëm i sigurisë dhe integritetit fizik të strukturave të akumulimeve ujore dhe një sistem "reagues" që përfshin masat e nevojshme për të mbajtur sigurinë dhe integritetin e strukturave të tilla. Këtu i referohemi raportit të ish-Task Forcës së Ujërave për Sigurinë e Digave.*

*Ky veprim përfshinë:*

- *Sqarimi ligjor i përgjegjësisë për sigurinë e digave (sipas nenit 42 i Ligjit për Ujëra dhe aktet nënligjore)*
- *Vlerësimi i digave;*
- *Sistemin e alarmit në rast rreziku*
- *Caktimi i një inspektorati të plotfuqishëm*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019. Lartësia e kostove është vlerësuar në 990,000 EUR.*

**b) Zbatimi**

- MMPHI ka zbatuar një projekt për vlerësimin e sigurisë së digave dhe rrezikun sizmik i cili është zbatuar në vitin 2021-2022. Në kuadër të këtij projekti janë trajnuar personeli i KRU-ve për sigurinë e digave.

- MMPHI ka hartuar Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2017 për Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave me të cilin janë përcaktuar përgjegjësitë institucionale për operimin dhe mirëmbajtjen e digave si dhe standardet e projektimit dhe ndërtimit.

**c) Progresi**

Progres substancial.

Veprimi 3.4.2: Renovimi i Digave Ekzistuese dhe Akumulimeve

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Vlerësim i detajuar (prioritetizuar nga raporti për TFU)*
- *Përgatitja e opsioneve për masat rinovuese*
- *Tenderimi dhe kontraktimi i masave infrastrukturore*

*Autoritet me përgjegjësi të drejtpërdrejt është MMPHI përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019. Kostot janë vlerësuar në 1.5 milion EUR.*

**b) Zbatimi**

- Në vitin 2018 është rehabilituar diga e Përlepnicës.

**c) Progresi**

Progres i pjesshëm.

## MASA 3.5: Menaxhimi i erozionit dhe rrëkeve

Kjo masë ka për qëllim të sigurojë zhvillimin dhe implementimin e aksionit për parandalimin dhe kontrollin e erozionit.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 3.5:** PA PROGRES

Për këtë masë janë planifikuar 2 veprime si vijon:

Veprimi 3.5.1: Përgatitja e Planeve për menaxhimin e rrëkeve dhe erozionit

**a) Planifikimi**

*Ky veprim ka për qëllim hartimin e raportit për vlerësimin e rrezikut nga erozioni në nivel komunal duke përfshirë përgatitjen e hartave dhe masave që duhet të ndërmerren për parandalimin e erozionit dhe përfshinë:*

- *Identifikimi i zonave erozive*
- *Caktimi i zonave të erozionit (nenet 51.2, 54.1)*
- *Përcaktimi i masave dhe detyrave (nenet 51.3, 54.2)*
- *Lajmërimi i banorëve dhe entiteteve ekonomike në zonat e përcaktuara erozive.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2019-2021.*

**b) Zbatimi**

- Nuk janë zhvilluar veprimet e planifikuara.

**c) Progresi**

Pa progres.

Veprimi 3.5.2: Implementimi i Planeve për Menaxhimin e Rrëkeve dhe Erozionit

**a) Planifikimi**

*Siç është përcaktuar në Ligjin për Ujëra, Plani për Menaxhimin e Erozionit duhet të përfshijë një numër masash duke përfshirë:*

- *Ndalimin e nxjerrjes së dheut, rërës, zhavorrit dhe gurëve;*
- *Ndalimin i shartimit, prerjeve dhe nxjerrjes së druve dhe vegjetacionit;*
- *Ndalimi i kullotjes nga kafshët;*
- *Pyllëzimi, mbjellja e barit; dhe*
- *Ndryshimet hidro-morfologjike (p.sh. argjinaturat, kanalizimet);*
- *Prerja e drunjëve mund të bëhet në kushte të caktuara, mënyra dhe procedura e të cilave siguron mbrojtjen nga erozioni dhe është në pajtim me Ligjin për Pyjet.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI dhe komunat, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2018-2022.*

**b) Zbatimi**

- Nuk janë zhvilluar veprimet e planifikuara.

**c) Progresi**

Pa progres.

## 4.4 Progresi kundrejt Objektivit Strategjik 4:

*"Të krijohet dhe të mirëmbahet një sistem i qeverisjes së ujit që është i drejtë, transparent, efikas, i koordinuar dhe me kapacitet të tillë profesional dhe teknik që të jetë në gjendje të mbështesë në mënyrë efektive arritjen e objektivave strategjike për shfrytëzimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave dhe mbrojtjen nga ujërat, duke përfshirë zbatimin e një sistemi të informacionit të ujërave për të monitoruar, vlerësuar, interpretuar dhe informuar palët e interesuara për të gjitha aspektet e kësaj Strategjie."*

### MASA 4.1: Legjislacioni për menaxhimin mjedisor të ujërave

Themeli i legjislacionit të menaxhimit të resurseve ujore është Ligji për Ujëra. Ligji po plotësohet me legjislacionin sekondar që mbulon një gamë të gjerë të çështjeve. Ky legjislacion paraqet një mundësi për rafinimin dhe modernizimin e aspekteve të legjislacionit të menaxhimit të ujërave për të reflektuar zhvillimet në Kosovë dhe Evropë.

Është qenësore që procesi legjislativ të përcillet me shpërndarjen, implementimin dhe zbatimin e tij. Për këtë qëllim duhet të bëhet një vlerësim për "barrierat për implementim".

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 4.1:** PROGRES I VOGËL

Për këtë masë janë planifikuar 3 veprime si vijon:

Veprimi 4.1.1: Vlerësimi i kostos së zbatimit të legjislacionit të propozuar

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Vlerësimi fillestar i Kostos së Zbatimit (i thjeshtuar)*
- *Përcaktimi i rëndësisë së kostove*
- *Vlerësimi i detajuar nëse konstatohet se kostot janë të rëndësishme*
- *Analiza e ndjeshmërisë: standardet kundrejt kostos*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI (tash MMPHI), përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Miratimi i secilit akt nënligjor përcilet me vlerësimin e kostove për zbatim.

- Janë hartuar dhe miratuar një numër i konsiderueshëm i akteve nënligjore që kërkohen sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës - gjashtë (6) në periudhën 2017-2021.

**c) Progresi**
Progres i pjesshëm.

Veprimi 4.1.2: Vlerësimi rregullator i legjislacionit të propozuar

**a) Planifikimi**
*Ky veprim përfshinë:*

- *Vlerësimi fillestar i implikimit të kostos (thjeshtuar)*
- *Përcaktimi i rëndësisë së kostove*
- *Vlerësimi i detajuar nëse konstatohet se kostot janë të rëndësishme*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk është hartuar një vlerësim i plotë i kostove për zbatimin e legjislacionit ujorë dhe transpozimit të direktivave të ujit.

**c) Progresi**
Pa progres.

Veprimi 4.1.3: Mbështetja për Implementimin e Legjislacionit për Menaxhimin e Ujërave

**a) Planifikimi**
*Ky veprim përfshinë:*

- *Publikimi i legjislacionit – baza e plotë e të dhënave në internet*
- *Procedura e shpërndarjes – reklamimi, njoftimet*
- *Tekste shpjeguese për të gjitha instruksionet ligjore*
- *Udhëzime dhe këshilla teknike për të gjitha palët e interesit*
- *Linjë ndihmëse / forume debati / e-mail*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk është kompletuar një sistem për mbështetje të zbatimit të legjislacionit që do të përfshinte udhëzuesit për zbatimin e të gjitha akteve normative dhe elementet tjera të planifikuara në kuadër të këtij veprimi.

**c) Progresi**
Pa progres.

## MASA 4.2: Tranzicioni drejt transpozimit të legjislacionit të BE

Kosova ka synim anëtarësimin në BE dhe për këtë arsye Kosova duhet ta kompletojë kornizën ligjore për të rritur shkallën e harmonizimit me kërkesat e BE në mënyrë që të arrijë një nga tri aspektet e përafrimit: transponzmin (që plotësohet me implementim dhe ekzekutim). Prandaj përgatitja e legjislacionit për menaxhimin e ujërave duhet të merr për bazë kërkesat e BE në perspektivën afatgjatë.

Niveli i përputhshmërisë me kërkesat e BE-së për momentin është i ulët. Përveç kësaj, niveli i investimeve për të arritur këtë është shumë i lartë. Prandaj arritja e përputhshmërisë së plotë do të merr kohë të gjatë për tu arritur. Përfundimisht, kapaciteti i autoriteteve kompetente nuk është ende i mjaftueshëm për të menaxhuar implementimin e plotë. Prandaj, duhet të adoptohet një qasje në faza.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 4.2:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 3 veprime si vijon:

Veprimi 4.2.1: Transpozimi i Procesit të Planifikimit të Menaxhimit të Ujërave

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Transpozimi i plotë i procesit të planifikimit të menaxhimit të pellgjeve lumore*
- *Integrimi i kërkesave për planifikimin e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet*
- *Transpozimi i plotë i kërkesave për autorizim (lejet ujore, Direktiva për Emetimet Industriale)*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI (tash MMPHI), përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Me legjislacionin e ujërave (Ligjin dhe aktet nënligjore) është transpozuar procesi i planifikimit të menaxhimit të resurseve ujore – që nënkupton se hartimi i planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore, hartimi i planit të menaxhimit të vërshimeve si dhe janë transpozuar kërkesat e legjislacionit të BE-së për shkarkimin e ujërave të ndotura.

**c) Progresi**

Progres substancial.

Veprimi 4.2.2: Transpozimi i Objektivave Afatgjata për Menaxhimin e Ujërave

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Transpozimi i Objektivave për Statusin e Ujërave Sipërfaqësore*
- *Transpozimi i Objektivave për Statusin e Ujërave Nëntokësore*
- *Transpozimi i vlerave kufizuese të shkarkimeve të Direktivës për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane*
- *Transpozimi i kërkesave të Direktivës së Emisioneve Industriale.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI përderisa periudha kohore për zbatim është 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Janë transpozuar me Ligjin për Ujëra dhe me aktet nënligjore të miratuara nga MMPHI gjatë periudhës 2017-2019.

**c) Progresi**

Progres substancial.

Veprimi 4.2.3: Përcaktimi i Objektivave Kalimtare

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Klasifikimi i Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësorë (shihe OSCE)*
- *Klasifikimi i Cilësisë së Ujërave Nëntokësore*
- *Vlerat Kufitare të Emisioneve*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2018-2020.*

**b) Zbatimi**

- Në procesin e hartimit të PMPL Drini i Bardhë është bërë klasifikimi i trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë dhe janë përcaktuar objektivat mjedisore transitore.
- Për pellgjet tjera lumore, procesi është në fillim.

**c) Progresi**

Progres i pjesshëm.

## MASA 4.3: Përforcimet institucionale

Institucionet ekzistuese për menaxhimin e ujërave kanë bërë përparim të dukshëm në dekadën e fundit, por një zhvillim i mëtutjeshëm është i nevojshëm për të siguruar që ata i kanë kapacitetet e duhura për të implementuar në tërësi Ligjin për Ujëra, si dhe programin e strategjisë dhe Planin e Veprimit dhe Investimeve. Në veçanti nevojitet që të:

- Të themelohet dhe të fillojë nga puna Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore
- Të përforcohet në masë të madhe Instituti Hidro-Meteorologjik

Këto masa do të kërkojnë një rritje në buxhetin e rregullt që ndahet për menaxhimin e ujërave në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e zhvillimeve të tilla.

Në interes të koordinimit dhe efiçencës, duhet bërë ndarjen dhe qartësimin e saktë të përgjegjësive ndërmjet DU dhe Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore në pajtim me Ligjin për Ujërat.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 4.3:** PROGRES I VOGËL

Për këtë masë janë planifikuar 5 veprime si vijon:

Veprimi 4.3.1: Themelimi dhe Funksionalizimi i plotë i Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore

**a) Planifikimi**

*Themelimi dhe funksionalizimi i Autoritetit për të Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) imponohet, jo vetëm si nevojë për menaxhimin efektiv të resurseve ujore, por gjithashtu edhe si një detyrim që del nga legjislacioni i zbatueshëm dhe dokumentet tjera strategjike të adoptuara nga institucionet e Kosovës*

*Ky veprim përfshinë:*

- *Definimi i punëve dhe përgjegjësive specifike të ARPL në pajtim me Ligjin për Ujërat;*
- *Hartimi i Udhëzimit Administrativ për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të ARPL;*
- *Emërimi i Drejtorit të ARPL dhe kompletimi i stafit (rekrutimi i stafit të ri dhe transferimi i stafit nga DU i MMPHI në pajtim me ndarjen e detyrave), gjithsej 28;*
- *Kompletimi i inventarit dhe mjeteve të punës*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI – periudha kohore për zbatim: 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) është themeluar në vitin 2017 por funksionon akoma si departament brenda MMPHI.
- Stafi i ARPL ende nuk është i kompletuar siç është ishte planifikuar me Strategji (28 persona).
- ARPL nuk është ende agjenci ekzekutive siç do të duhej të ishte duke pasur parasysh faktin se është themeluar me ligj.
- ARPL është përkrahur me 4 profesionistë të rinj, ndërsa IHMK dhe AMMK me nga një, përmes programit për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore (MIRU) në Kosovë.

**c) Progresi**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 4.3.2: Përforcimi i divizionit të ujërave të Inspektoratit Mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

**a) Planifikimi**

*Inspektorati i Ujërave brenda Inspektoratit Shtetëror Mjedisor të Kosovës (ISHMK) është përgjegjës për inspektimin dhe zbatimin e ligjeve mjedisore. Për momentin janë 3 inspektorë për ujëra. Ky numër do të rritet me 5 inspektorë shtesë që do të përbëjnë gjithsej 8 inspektorë për ujëra.*

*Ky veprim përfshinë:*

- *Krijimi i pozitave të reja (5)*
- *Rekrutimi i personelit të ri*
- *Trajnimi dhe integrimi i tyre.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2018.*

**b) Zbatimi**

- Nuk është rritur fare numri i inspektorëve të ujërave.

**c) Progresi**

Pa progres.

Veprimi 4.3.3: Përforcim substancial i Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Akreditimin e laboratorit;*
- *Punësimin e 10 punonjësve shtesë;*
- *Instalimin e datalogerëve për 69 lokacione;*
- *Trajnimi i stafit për punë me GC-MS dhe ICP-MS;*
- *Trajnimi për monitorimin e akumulacioneve, cilësorë dhe sasiorë;*
- *Forcimi i kapacitetit të laboratorëve të IHMK-së për analizimin e substancave prioritare dhe substancave tjera;*
- *Dizajni i programeve për monitorim dhe vlerësim të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore në pajtim të plotë më Direktivën Kornizë të Ujërave.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2018-2020.*

*Kostot e vlerësuara janë: 1,187,843 EUR kosto kapitale, dhe 413,311 EUR kosto operative.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka pasur progres në zbatimin e veprimeve të planifikuara.

**c) Progresi**

Pa progres

Veprimi 4.3.4: Themelimi i Institutit për Ujërat.

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë përgatitjen nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të propozimit për detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Institutit për ujëra duke përfshirë draftimin e Statutit të Aktiviteteve për konsultime dhe aprovim.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI, përderisa periudha kohore për zbatim ishte planifikuar të jetë 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk janë zhvilluar përgatitjet për themelimin e Institutit për Ujëra, por edhe ashtu nuk konsiderohet veprim i qëlluar dhe me ligjin e ri pritet të hiqet në tërësi kjo kërkesë.

c) **Progresi**
Pa progres.

Veprimi 4.3.5: Fuqizimi i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

a) **Planifikimi**

*Si rezultat i inicimit të trajtimit të ujërave të ndotura në qytetet kryesore, Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU) do të ngarkohet me punë shtesë rregullatore. Prandaj ARRU-së i nevojiten dy persona shtesë.*

*Ky veprim përfshinë:*

- *Krijimi i pozitave të reja për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura*
- *Rekrutimi i stafit të ri*
- *Trajnimi dhe zotimi*

*Autoritet përgjegjës është ARRU përderisa periudha kohore për zbatim është 2019-2021.*

b) **Zbatimi**

- Nuk janë rekrutuar persona shtesë për ujëra të ndotura.

c) **Progresi**
Pa progres.

## MASA 4.4: Menaxhimi i informacioneve

Kjo masë ka të bëj me krijimin e një sistemi të informacionit si dhe përgatitjen e procedurave për shkëmbimin ndërinstitucional të të dhënave.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 4.4:** PROGRES I PJESSHËM

Për këtë masë janë planifikuar 3 veprime si vijon:

Veprimi 4.4.1: Sistemi i informacioneve për Ujërat

a) **Planifikimi**

- *Sistemi Informativ Ujor (SIU), brenda Sistemit të Informacioneve Mjedisore të Kosovës do të jetë burimi kryesor i informacioneve mjedisore dhe rregullatore për sektorin e ujërave.*
- *Baza e informacioneve do të funksionojë nën mbikëqyrjen e DMK.*
- *Të gjitha informacionet do të ndahen.*

*Autoritet përgjegjës është MMPHI – periudha kohore për zbatim: 2017-2018.*

b) **Zbatimi**

- Është nxjerrë UA për Sistemin Informativ Ujor Nr. 07/2016 - https://siu.rks-gov.net/
- Ekziston SIU i krijuar në vitin 2020;

c) **Progresi**
Progres i pjesshëm.

Veprimi 4.4.2: Marrëveshja dhe Procedura e Shkëmbimit Ndërinstitucional i të Dhënave

a) **Planifikimi**

*Një marrëveshje në mes të gjitha institucioneve qeveritare që merren me sektorin e ujërave që të ndajnë informacionet përmes SIU (siç është përshkruar me lartë)*

*Autoritet përgjegjës: Këshilli Ndërministrore për Ujëra - periudha kohore për zbatim: deri 2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka një marrëveshje formale për këtë qëllim.

**c) Progresi**

Pa progres

Veprimi 4.4.3: Publikimi i të gjitha të dhënave për sektorin e ujërave përmes një portali në internet

**a) Planifikimi**

*Në pajtim me kërkesat e Konventës së Aarhus-it dhe legjislacionit të BE për qasjen në informacionet mjedisore, DMK dhe SIU do të bëjnë publikimin në internet të të gjitha informacioneve mjedisore që kanë në dispozicion (përveç atyre që konsiderohen së janë të ndjeshme nga aspekti komercial). Autoritet përgjegjës është Këshilli Ndërministror për Ujëra – periudha kohore për zbatim: 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka një marrëveshje formale për këtë qëllim.

**c) Progresi**

Pa progres

## MASA 4.5: Edukimi në menaxhimin e ujërave

Kjo masë është planifikuar të zbatohet përmes 3 veprimeve si vijon:

1) Fushata publike e ndërgjegjësimit për çështjet e ujërave
2) Të sigurohet që kurrikula shkollore përfshinë përmbajtje të duhur që ka të bëjë me ujërat
3) Implementimi i rekomandimeve të studimit të TFU për zhvillimin akademik

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 4.5:** PROGRES SUBSTANCIAL

Veprimi 4.5.1: Fushata publike e ndërgjegjësimit për çështjet e ujërave

**a) Planifikimi**

*Shembuj të temave:*

- *Përdorimi i ujërave*
- *Kërkesat ligjore*
- *Mbështetje për familjet me të ardhura të ulëta.*

*Autoritet përgjegjës:*

- *Këshilli Ndërministrorë për Ujëra*
- *Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*
- *Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*
- *Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit*
  *periudha kohore për zbatim: 2017.*

**b) Zbatimi**

- Përmes projektit RCDN në bashkëpunim të komunave dhe KRU-ve janë mbajtur takime me zyrtarët komunalë për tema me interes për çështjet e ujërave.
- Përmes projektit Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU) i bashkë-financuar me Qeverinë e Zvicrës publikohet buletini “Uji i Kosovës” ku jepen informacione për qëllime të ndërgjegjësimit për çështjet për ujërat.

**c) Progresi**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 4.5.2: Kurrikula shkollore përfshinë përmbajtje të duhur që ka të bëjë me ujërat

**a) Planifikimi**

*Të sigurohet që kurrikula shkollore përfshinë përmbajtje të duhur që ka të bëjë me ujërat duke përfshirë:*

- *Ciklin Ujorë*
- *Shfrytëzimin e Ujërave*
- *Ndotjen e Ujërave*
- *Kursimin e Ujit*
- *Parandalimin e ndotjes së ujërave*
- *Rrezikun nga vërshimet*

*Autoritet përgjegjës: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)*

*Periudha kohore për zbatim: 2018-2020.*

**b) Zbatimi**

- Nuk ka informacion se a ekziston një marrëveshje formale për këtë qëllim.

**c) Progresi**

Pa progres

Veprimi 4.5.3: Implementimi i rekomandimeve të studimit të Task Forca e Ujërave (TFU) për zhvillimin akademik

**a) Planifikimi**

*TFU e cila ka funksionuar prej vitit 2009 deri 2013 (më vonë përmes Ligjit për Ujëra është zëvendësuar/transformuar në Këshillin Ndërministror për Ujëra), kishte hartuar një studim për zhvillimin akademik në sektorin e ujërave.*

*Autoritet përgjegjës: MASHT dhe MMPHI*

*Periudhe kohore: 2017-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nga viti 2023 do të fillojë programi i studimeve Master në menaxhimin e integruar të resurseve ujore i cili program financohet përmes projektit MIRU.

**c) Progresi**

Progres i pjesshëm

## MASA 4.6: Planifikimi për menaxhim të integruar të pellgjeve të lumenjve

Kjo masë ka të bëj me hartimin e planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore sipas cikleve 6-vjeçare të përcaktuara me DKU dhe Ligjin për Ujëra.

**Vlerësimi i progresit për zbatimin e Masës 4.6:** PROGRES I PJESSHËM

Veprimi 4.6.1: Planet e Para për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve

**a) Planifikimi**

*Në bazë të Ligjit për Ujëra këto plane është dashur të jenë të gatshme në vitin 2017. Ato duhej të mbulonin periudhën deri në vitin 2020. Ato do të duhej të bazohen në:*

- *Karakterizimin e pellgjeve të lumenjve të përgatitura nga MMPHI me vlerësimin e projektit të financuar nga BE, Strategjia, Plani i veprimit për implementimin e Strategjisë.*
- *Politikat e bazuara në këtë Strategji*
- *Masat e bazuara në këtë Planin e Veprimit*

*Autoritet përgjegjës:*

- *Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*
- *Periudha kohore për zbatim: 2019*

**b) Zbatimi**

- Plani për Menaxhimin e Pellgut të Lumit Drini i Bardhë është në fazën e finalizimit, me mbështetjen financiare nga Qeveria e Suedisë (SIDA).
- Planet për menaxhimin e tri pellgjeve tjera lumore (Lepenci, Ibri dhe Morava e Binçës) janë në fazën fillestare të planifikimit, me mbështetjen financiare të Qeverisë së Zvicrës përmes programit MIRU.

**c) Progresi**

Progres i pjesshëm.

Veprimi 4.6.2: Përgatitja e Planeve të Dyta për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Definimi i procesit – Definimi i procesit për Përgatitjen e Planeve të dyta për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve*
- *Marrëveshja për proces – konsultimi, negocimi dhe marrëveshja në mes të palëve kyçe qeveritare të interesit për procesin e PMPL*
- *Trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve*

*Autoritet përgjegjës: MMPHI*

*Periudha kohore për zbatim: 2018-2019.*

**b) Zbatimi**

- Nuk janë kryer - nuk janë kompletuar ende planet e para.

**c) Progresi**

Pa progres.

Veprimi 4.6.3: Përafrimi i dytë i Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve të Lumenjve

**a) Planifikimi**

*Ky veprim përfshinë:*

- *Karakterizimin*
- *Analizën e Opsioneve*
- *Analizën e Kosto-efektivitetit*
- *Programin e Masave*
- *Konsultimet*
- *Publikimet*

*Autoritet përgjegjës: MMPHI dhe Këshilli Ndërministror për Ujëra.*

*Periudha kohore: 2019-2022.*

**b) Zbatimi**

- Nuk është kryer ende.

**c) Progresi**

Pa progres.

# 5. PËRMBLEDHJE E PROGRESIT DHE REKOMANDIME

## 5.1 Monitorimi i zbatimit të Strategjisë

Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës është dokument kryesor planifikues në fushën e ujërave i hartuar në bazë të Ligjit për Ujëra për periudhë kohore 20-vjeçare. Qëllimi i këtij dokumenti është që të ofrojë zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar të sektorit të ujërave duke i plotësuar nevojat për: furnizim me ujë, ujin për prodhimin e ushqimit, ujitje dhe bujqësi, industri, prodhim të energjisë, peshkim, turizëm, sport dhe rekreacion.

- Me Strategji janë përcaktuar 4 objektiva strategjike si vijon:

  1) **Shfrytëzimi i ujit**
     "Të ndahet dhe mbikëqyret në mënyrë të qëndrueshme e drejta për shfrytëzimin e burimeve ujore të Kosovës tek të gjithë shfrytëzuesit e ujit ashtuqë të garantohet për të gjithë qasja në ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin dhe të maksimizohen përfitimet ekonomike nga përdorimet tjera të ujit, duke marrë në konsideratë ndryshimin e regjimeve hidrologjike, eliminimin e mungesës së ujit dhe duke respektuar parimin e menaxhimit të qëndrueshëm."

  2) **Mbrojtja e ujërave**
     "Të rregullohen dhe mbikëqyren aktivitetet që rrisin presionin në mjedisin ujorë në mënyrë proporcionale, efiçiente dhe efektive, në mënyrë që të arrihen objektiva mjedisore të arsyetuara nga aspekti ekonomik për trupat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore duke respektuar njëkohësisht parimet e menaxhimit të qëndrueshëm."

  3) **Mbrojtja nga ujërat**
     "Të arrihen nivele të pranueshme të mbrojtjes së popullsisë dhe pronës nga efektet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë vërshimet, rrëketë dhe erozionin në një mënyrë që është ekonomikisht e ekuilibruar dhe me kosto efektive."

  4) **Qeverisja**
     "Të krijohet dhe të mirëmbahet një sistem i qeverisjes së ujit që është i drejtë, transparent, efikas, i koordinuar dhe me kapacitet të atillë profesional dhe teknik që të jetë në gjendje të mbështesë në mënyrë efektive arritjen e objektivave strategjike për shfrytëzimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave dhe mbrojtjen nga ujërat, duke përfshirë zbatimin e një sistemi të informacionit të ujërave për të monitoruar, vlerësuar, interpretuar dhe informuar palët e interesuara për të gjitha aspektet e kësaj Strategjie."

- Arritja e 4 objektivave strategjikë të Strategjisë është planifikuar të bëhet përmes **29 masave** specifike (10 për objektivin e parë, 8 për objektivin e dytë, 5 për objektivin e tretë, dhe 6 për objektivin e katërt). Për secilën prej masave janë përcaktuar veprimet për zbatimin e tyre, gjithsej **74 veprime** (31 për objektivin e parë, 15 për objektivin e dytë, 13 për të tretin dhe 20 për objektivin e katërt).

- Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë është bërë për **secilin veprim** veç e veç, pastaj bazuar në zbatimin e veprimeve është vlerësuar se në çfarë shkalle janë zbatuar masat dhe përfundimisht, bazuar në vlerësimin për masat e zbatuara është vlerësuar edhe shkalla e arritjes së objektivave strategjik. Vlerësimi është bërë duke u bazuar në të dhënat e ofruara nga institucionet dhe organizatat përgjegjëse në pyetësorët e dërguar për këtë qëllim; gjithashtu janë shfrytëzuar edhe dokumentet dhe raportet e disponueshme në internet të institucioneve relevante (si Agjencia e Statistikave të Kosovër, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përfshirë insitucionet që janë në kuadër të kësaj Ministrie si Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore dhe Instituti Hidrometeorologjik, pastaj Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, Kompanitë Rajonale të Ujit, komunat, etj.).

## 5.2 Vlerësimi sipas objektivave strategjikë dhe rekomandimet

### (i) OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHFRYTËZIMI I UJIT

Vlerësimi për 10 masat e planifikuara për arritjen e këtij objektivi strategjik është si vijon:

- Progres substancial – 3
- Progres i pjesshëm – 6
- Progres i vogël – 0
- Pa progres – 1

Ky është objektivi strategjik për të cilin ka pasur më shumë progres krahasuar me objektivat tjerë strategjikë. [Arritja e këtij objektivi strategjik është vlerësuar me K=3.3[3]]

**Progres substancial** është vlerësuar se ka pasur në tri prej masave:

Masa 1.4: Zvogëlimi i shkallës së mospagesës për ujin e shfrytëzuar – KRU-të kanë arritur shkallën e arkëtimit të faturave në 96%, MMPHI ka rritur substancialisht shkallën e arkëtimit të pagesave ujore në dy vitet e fundit, Kompanitë e Ujitjes gjithashtu kanë shënuar rritje të konsiderueshme të shkallës së arkëtimit të faturave për ujin e furnizuar.

Masa 1.6: Arritja e përputhshmërisë me Direktivën e BE-së për Ujin e Pijshëm – Direktiva e Ujit të Pijshëm është transpozuar në legjislacionin kosovar, shkalla përputhshmërisë së cilësisë së ujit të furnizuar përmes sistemeve publike të ujësjellësit është mbi 98%, të gjitha KRU-të kanë laboratore të cilësisë së ujit – 2 prej tyre të akredituara, të tjerat në proces të akreditimit;

Masa 1.7: Programi i investimeve për sistemet e furnizimit me ujë (24.7 milion EUR për periudhën 2017-2021) – Janë tejkaluar investimet e planifikuara meqenëse janë investuar në total rreth 129 milion EUR (faza e VI-të e programit RWSSP për sistemet rurale në bashkëfinancim të Qeverisë së Kosovës me Qeverinë Zvicerane në vlerë 15.75 mil EUR, përmes KRU-ve nga të hyrat vetanake dhe grantet në vlerë 88.5 mil EUR, përmes komunave rreth 20 mil EUR, përmes MMPHI janë investuar rreth 5 mil EUR.

**Progres i pjesshëm** është vlerësuar për shumicën e masave të këtij objektivi strategjik – 6 sosh.

Progresi në zbatimin e këtyre nuk është plotësisht në pajtim me dinamikën dhe veprimet e planifikuara, dhe rrjedhimisht nevojitet angazhim më i madh në zbatimin e tyre. Kjo sidomos kur merretparasysh fakti se këto masa janë esencialisht të rëndësishme për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm afatgjatë të popullatës dhe ekonomisë me ujë (siç janë: Masa 1.1 Rritja e kapaciteteve për akumulimin dhe ruajtjen e resurseve ujore; Masa 1.2: Rritja e efiçencës në shfrytëzimin e ujit; Masa 1.3: Sigurimi i kontrollit mbi të gjitha shfrytëzimet e resurseve ujore; Masa 1.5: Integrimi i sistemeve rurale dhe lokale në KRU; Masa 1.8: Optimizimi i mbulueshmërisë me sistem për ujitje, dhe Masa 1.10: Plani për menaxhimin e thatësirave).

**Pa progres** është vlerësuar një prej masave të planifikuara:

Masa 1.9: Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujit nga shfrytëzues tjerë – ku asnjëri prej veprimeve të planifikuara për këtë masë (Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për turizëm dhe rekreacion, Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për ferma të peshqve, Përgatitja e një strategjie për shfrytëzimin e qëndrueshëm të inerteve nga pellgjet lumore, Dhënia e lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale duke respektuar nevojat dhe të drejtat e shfrytëzuesve që gjenden në rrjedhën e poshtme) nuk është implementuar.

**Rekomandohet** që me prioritet të rritet dinamika dhe angazhimi i resurseve në zbatimin e masave dhe veprimeve për të cilat nuk ka pasur fare progres apo që ka pasur progres të pamjaftueshëm (*progres i pjesshëm*). Në veçanti, angazhim shtesë rekomandohet në lidhje me masat dhe veprimet që kanë të bëjnë me **shtimin e kapaciteteve për akumulimin e ujit** si

[3] Koeficienti *K* është përllogaritur si mesatare aritmetikore e shkallës së zbatimit të masave duke i kuantifikuar progresin e zbatimit të masave si vijon: *progres substancial*-5, *progres i pjesshëm*-3, *progres i vogël*-1, *pa progres*-0.

dhe **rritjen e eficçencës për shfrytëzimin e ujit**, kur të merret parasysh se: (i) Kosova ka resurse modeste ujore, (ii) ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike, dhe (iii) rëndësinë esenciale të ujit për zhvillim social dhe ekonomik.

**Figura 1: Paraqitja grafike e progresit në përmbushjen e objektivit strategjik 1**




## (ii) OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MBROJTJA E UJËRAVE

Vlerësimi për 8 masat e planifikuara për arritjen e këtij objektivi strategjik është si vijon:

- Progres substancial – 2
- Progres i pjesshëm – 2
- Progres i vogël – 2
- Pa progres – 2

Progresi për këtë objektiv strategjik, në kuptimin kuantitativ të zbatimit të masave dhe veprimeve, është më i vogël se sa progresi për objektivin strategjik 1.

[Arritja e këtij objektivi strategjik është vlerësuar me K=2.25]

**Progres substancial** është vlerësuar se ka pasur në 2 prej masave:

Masa 1.4: Implementimi i trajtimit të ujërave të ndotura – Është rritur substancialisht shkalla e trajtimit të ujërave të ndotura, nga 1% në 11%. Janë finalizuar dhe janë lëshuar në funksion impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën. Janë në fazën e planifikimit dhe projektimit impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Prishtinën, Gjilanin dhe Mitrovicën (këto impiante planifikohet të kompletohen deri në vitin 2026). Është ndërtuar impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në fshatin Orllan me qëllim të mbrojtjes së akumulimit të Batllavës.

Masa 1.5 Programi i investimeve për menaxhimin e ujërave të ndotura (46.2 mil. EUR, 2017-2021) – Janë kryer investime në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në vlerë mbi 60 milion EUR (ITUN për Prizrenin, Pejën dhe

Gjakovën) që tejkalon shumën e planifikuar. Janë zgjidhur modalitetet e investimit për implementimin e investimeve në trajtimin e ujërave të ndotura në vlerë rreth 150 mil. EUR (ITUN për Prishtinën, Mitrovicën dhe Gjilanin).

**Progres i pjesshëm** është vlerësuar për dy prej masave:

Masa 2.2: Zgjerimi i mbulueshmërisë me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura – Mbulueshmëria me sisteme publike të grumbullimit të ujërave të ndotura ka arritur në 75% të popullsisë – prej tyre 65% menaxhohen nga KRU-të (në zonat urbane 97% ndërsa në zonat rurale 46%). Në periudhën 2018-2020 janë zbatuar 8 projekte përmes MMPHI me të cilat janë ndërtuar sistemet e kanalizimit për 30 fshatra.

Masa 2.3: Përmirësimi dhe ruajtja e funksionalitetit të sistemeve ekzistuese të grumbullimit të ujërave të ndotura – Janë zbatuar projektet për rehabilitimin e rrjetiti të kanalizimit të mbështetura nga KfW në Prizren, Pejë dhe Gjakovë në vlerë totale 17.5 mil. EUR. Është kompletuar studimi i fizibilitetit për sistemin e kanalizimit të rajonit të Prishtinës mbështetur nga KfW. Është në përgatitje projekti për përmirësimin e sistemit të kanalizimit në rajonin e Prishtinës (komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Podujevë) mbështetur nga KfW në vlerë rreth 70 milion EUR.

**Progres i vogël** sa i përket zbatimit është vlerësuar për dy prej masave si vijon:

Masa 2.1: Kontrollimi i shkarkimeve ndotëse – Progresi i vetëm sa i përket kësaj mase është planin legjislativ: është miratuar nga MMPHI *Udhëzimi i ri Administrativ nr. 02/2022 për Vlerat Kufizuese të Shkarkimeve të Ujërave të Ndotura në Trupat Ujorë dhe në Kanalizimin Publik* me të cilin është transpozuar Direktiva Nr. 91/271/EEC për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane. Në anën tjetër, MMPHI nuk e ka krijuar ende një regjistër të plotë të shkarkimeve të ujërave të ndotura më trupat ujorë nga objektet e mëdha industriale me karakteristikat e shkarkimeve. KRU-të, gjithashtu, nuk i kanë kompletuar regjistrat për shkarkimet e ujërave të ndotura industriale në kanalizimin publik.

Masa 2.6: Menaxhimi i llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura – Nuk është hartuar ende një strategji në nivel të shtetit për menaxhimin e llumit të kanalizimit. Në vend të kësaj, në vitin 2022 është iniciuar hartimi i planeve për menaxhimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura me vendim të Këshillit Ndërministror për Ujëra.

**Pa progres** janë vlerësuar dy prej masave të planifikuara:

Masa 2.7: Menaxhimi i ndotjes difuzive nga bujqësia – Nuk ka pasur asnjë progres: nuk janë hartuar udhëzimet për përdorimin e plehrave në bujqësi e as udhëzimet për përdorimin e biocideve nga MBPZHR.

Masa 2.8: Ulja e ndotjeve difuzive nga burimet jo-bujqësore – Nuk ka pasur asnjë progres: nuk është përgatitur nga MMPHI regjistri i tokave të kontaminuara e as strategjia për rehabilitimin e tokave të kontaminuara.

**Rekomandohet** që:

- Të vazhdohet me dinamikën e planifikuar sa i përket investimeve në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura;
- Të shpejtohet dinamika e investimeve e ndërtimit të sistemeve të kanalizimit në zonat rurale;
- Të trajtohet si çështje me prioritet kontrollimi i shkarkimit të ndotësve dhe problemi i menaxhimit të llumit të kanalizimit (përfshirë hartimin e strategjisë për menaxhimin e llumit);
- Të adresohet në tërësinë e vet dhe përmes bashkëpunimit ndër-insitutcional (MMPHI me MBPZHR dhe komunat) problemi i ndotjes difuzive nga bujqësia dhe aktivitetet jo-bujqësore.

**Figura 2: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 2**




## (iii) OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: MBROJTJA NGA UJËRAT

Vlerësimi për 5 masat e planifikuara për arritjen e këtij objektivi strategjik është si vijon:

- Progres substancial – 0
- Progres i pjesshëm – 2
- Progres i vogël – 2
- Pa progres – 1

Progresi për këtë objektiv strategjik, në kuptimin kuantitativ të zbatimit të masave dhe veprimeve, është më i ulëtikrahasuar me objektivat tjerë strategjikë.

[Arritja e këtij objektivi strategjik është vlerësuar me K=1.6]

**Progres i pjesshëm** është vlerësuar për dy prej masave:

Masa 3.2: Paralajmërimi i vërshimeve dhe menaxhimi i emergjencave – Progres në zbatimin e kesaj mase paraqet fakti se Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës e ka krijuar sistemin e paralajmërimit të hershëm të përmbytjeve përmes ISR. Ky sistem duhet të avancohet dhe të lidhet me MeteoAlarm. Gjithashtu, procedurat për veprim në rast të vërshimeve janë përcaktuar me UA nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave.

Masa 3.4: Sigurimi që të gjitha strukturave ekzistuese akumuluese janë të sigurta – Siguria e digave është adresuar nga MMPHI që ka zbatuar një projekt për vlerësimin e sigurisë së digave dhe rrezikun sizmik i cili është zbatuar në vitin 2021-2022. Në kuadër të këtij projekti janë trajnuar personeli i KRU-ve për sigurinë e digave. Në anën tjetër, në vitin 2018 është rehabilituar diga e Përlepnicës. Poashtu, progres paraqet edhe nxjerrja e *Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2017 për Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave* me të cilin janë përcaktuar përgjegjësitë institucionale për operimin dhe mirëmbajten e digave si dhe standardet e projektimit dhe ndërtimit.

**Progres i vogël** sa i përket zbatimit është vlerësuar për dy prej masave si vijon:

Masa 3.1: Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga vërshimet – Me këtë masë ishte paraparë hartimi i planeve të menaxhimit të rrezikut nga vërshimet dhe zbatimi i tyre. Kjo nuk është kryer deri tash. Një aktivitet dhe progres është arritur nga viti 2020 kur është kryer *vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet*, përmes një projekti të financuar nga donatorët në vlerë 0.6 mil. EUR. Gjithashtu, në vitin 2021 është filluar projekti për përgatitjen e *hartave të rrezikut*

*nga përmbytjet për të gjitha pellgjet lumore të Kosovës*, të cilat janë kompletuar në vitin 2022 (vlera e projektit 2.5 mil. EUR).

**Pa progres** është vlerësuar një prej masave të planifikuara:

Masa 3.5: Menaxhimi i erozionit dhe rrëkeve – Asnjëri prej dy veprimeve të planifikuara në kuadër të kësaj mase nuk është realizuar: nuk janë përgatitur dhe nuk janë zbatuar Planet për menaxhimin e rrëkeve dhe erozionit.

**Rekomandohet** që:

- Të vazhdohen aktivitetet e planifikuara me Strategji sa i përket: (i) sigurisë së digave, (ii) paralajmërimit të emergjencave, (iii) menaxhimit të rrezikut nga vërshimet;
- Të fillohet me punët në planifikimin dhe menaxhimin e rrëkeve dhe erozionit.

**Figura 3: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 3**




## (iv) OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: QEVERISJA

Vlerësimi për 6 masat e planifikuara për arritjen e këtij objektivi strategjik është si vijon:

- Progres substancial – 0
- Progres i pjesshëm – 3
- Progres i vogël – 3
- Pa progres – 0

[Arritja e këtij objektivi strategjik është vlerësuar me K=2]

**Progres i pjesshëm** është vlerësuar për 3 prej masave:

Masa 4.2: Tranzicioni drejt transpozimit të legjislacionit të BE – Me Ligjin për Ujëra dhe aktet nënligjore të miratuara nga MMPHI gjatë periudhës 2017-2019 është transpozuar procesi i planifikimit të menaxhimit të resurseve ujore

(PMPL, Planet e Vërshimeve, afatet dhe përmbajtja etj.). Si progres vlerësohet edhe transpozimi i parimeve të planifikimit të menaxhimit të ujërave.

Masa 4.4: Menaxhimi i informacioneve – Është krijuar një sistem informativ i menaxhimit të ujërave në vitin 2021, i cili duhet të zhvillohet më tutje dhe të plotësohet me të dhëna. Nuk janë kompletuar procedurat formale të shkëmbimit të të dhënave relevante për menaxhimin e ujërave.

Masa 4.5: Edukimi në menaxhimin e ujërave – Përmes projektit Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore (MIRU) i financuar nga Qeveria e Zvicrës publikohet buletini "Uji i Kosovës" ku jepen informacione për qëllime të ndërgjegjësimit mbi çështjet për ujëra. Përmes këtij projektit është planifikuar dhe pritet të fillojë në vitin 2023 programi Master në menaxhimin e resurseve ujore në kuadër të Universitetit "Hasan Prishtina".

**Progres i vogël** sa i përket zbatimit është vlerësuar për 3 prej masave si vijon:

Masa 4.1: Legjislacioni për menaxhimin mjedisor të ujërave – Miratimi i secilit akt nënligjor përcjellet me vlerësimin e kostove për zbatim. Janë hartuar dhe miratuar një numër i konsiderueshëm i akteve nënligjore që kërkohen sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës - gjashtë në periudhën 2017-2021. Nuk është hartuar një vlerësim i plotë i kostove për zbatimin e legjislacionit ujorë dhe transpozimit të direktivave të ujit. Nuk është kompletuar një sistem për mbështetje të zbatimit të legjislacionit që do të përfshinte udhëzuesit për zbatimin e të gjitha akteve normative.

Masa 4.3: Përforcimet institucionale – Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) është themeluar dhe prej vitit 2017 funksionon si departament brenda MMPHI. Personeli i ARPL nuk është kompletuar ende sipas strukturës organizative të tij. Nuk ka pasur progres të duhur në fuqizimin institucional të Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK): laboratori ka mbetur i pa-akredituar, personeli nuk është rritur. Inspektorati Mjedisor nuk është kompletuar sipas SSHUK–nuk është rritur numri i inspektorëve me 5 inspektorë shtesë siç ishte planifikuar. Instituti për Ujëra nuk është themeluar.

Masa 4.6: Planifikimi për menaxhim të integruar të pellgjeve lumore – Plani për Menaxhimin e Pellgut të Lumit Drini i Bardhë është në fazën e finalizimit, me mbështetjen financiare nga Qeveria e Suedisë (SIDA). Planet për menaxhimin e tri pellgjeve tjera lumore (Lepenci, Ibri dhe Morava e Binçës) janë në fazën fillestare të planifikimit, me mbështetjen financiare të Qeverisë së Zvicrës përmes programit MIRU.

**Rekomandohet** që:

- Të kompletohet transpozimi i legjislacionit të ujërave të BE-së me Ligjin e ri për Ujëra dhe aktet nënligjore;
- Të kompletohet dhe të avancohet procesi i menaxhimit të informacioneve të ujërave;
- Të krijohet sistemi për mbështetjen e zbatimit të legjislacionit të ujërave (udhëzuesit për palët e interesit);
- Të kompletohet procesi i hartimit të planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore dhe planeve të menaxhimit të vërshimeve.

**Figura 4: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 4**




Në vazhdim është paraqitur në formë tabelare një përmbledhje e progresit në zbatimin e Strategjisë sipas objektivave objektivave strategjikë, përmes masave dhe veprimeve të planifikuara.

**Figura 5: Përmbledhje tabelare e progresit në zbatimin e Strategjisë**

| Masa | Veprimet e planifikuara | Zbatimi | Veprimet e ndërmarra | Progresi i vlerësuar |
|---|---|---|---|---|
| **OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHFRYTËZIMI I UJËRAVE**<br>***"Të shpërndajë dhe shfrytëzojë në mënyrë të qëndrueshme resurset ujore të Kosovës tek shfrytëzuesit e saj në mënyrë që të garantojë qasje në ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin për të gjithë dhe të maksimizojë përfitimet ekonomike nga përdorimi i ujërave për qëllime tjera"*** | | | | |
| **Masa 1.1: Rritja e kapaciteteve për akumulimin dhe ruajtjen e resurseve ujore.** | ▪ Hartimi i studimit të fizibilitetit për rritjen e kapaciteteve akumuluese të ujit: Të gjitha pellgjet.<br>▪ Mbështetja në zbatim (hartimi i dokumentacionit projektues dhe tenderues për projektet prioritare) – rritja e kapacitetit të depozitimit të ujit: Të gjitha pellgjet.<br>▪ Ndërtimi – rritja e kapacitetit për akumulimin e ujit: Të gjitha pellgjet. | ▪ Pjesërisht<br>▪ Pjesërisht<br>▪ JO | ▪ Është hartuar studimi i fizibilitetit për hidrosistemin Lepenc (2020).<br>▪ Janë planifikuar për vitin 2023 studimet e fizibilitetit për akumulimet: Dragaçinë, Pollatë dhe Drelaj.<br>▪ Është në proces hartimi i projektit ideor ("preliminary design") dhe studimit të VNSM për sistemin Lepenc.<br>▪ Në kuadër të projektit FLOWS është formuar NJZP për akumulimin e Desivojcës.<br>▪ Nuk ka filluar ende ndërtimi i akumulimeve. | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 1.2: Rritja e efiçencës në shfrytëzimin e ujit.** | ▪ Zvogëlimi i rrjedhjeve nga sistemet e furnizimit të ujit me shumicë.<br>▪ Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e furnizimit me ujë.<br>▪ Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e ujitjes.<br>▪ Rritja e efiçencës në shfrytëzimin e ujit për ujitje. | ▪ Nuk ka info<br>▪ **PO**<br>▪ JO<br>▪ JO | ▪ Të gjitha KRU-të i kanë hartuar Strategjitë për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit: 2018-2022.<br>▪ Humbjet e ujit në nivel të sektorit të shërbimeve të ujit, në periudhën 2017-2021, janë zvogëluar për 3 pikë të përqindjes (nga 58% në 55%).<br>▪ Për Kompanitë e Ujitjes dhe për furnizuesit e ujit me shumicë nuk ka informacion nëse kanë hartuar strategji për zvogëlimin e humbjeve dhe sa është progresi në zvogëlimin e humbjeve të ujit. | Progres i pjesshëm nga KRU-të. |
| **Masa 1.3: Sigurimi i ushtrimit të kontrollit mbi të gjitha burimet ujore.** | ▪ Fushata e zbatimit të lejeve për shfrytëzimin e ujërave.<br>▪ Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit të pijshëm.<br>▪ Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit për ujitje. | ▪ Nga 2021<br>▪ Pjesërisht<br>▪ S`ka info | ▪ Inspektorati i Ujërave ka hartuar: 806 procesverbale, 143 inicime për kundërvajtje, 287 vendime dhe 218 gjoba administrative.<br>▪ ARPL ka ngritur efikasitetin e kontrollit mbi shfrytëzimin e ujit sidomos në vitin 2021 kur janë lëshuar 116 leje ujore (krahasuar me vitin 2020 kur janë lëshuar 68 leje ujore, dhe me vitin 2019 kur janë lëshuar 9 leje ujore).<br>▪ KRU-të kanë zvogëluar UPF për 3 pikë të përqindjes. | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 1.4: Zvogëlimi i** | ▪ Rritja e nivelit të pagesave për shfrytëzimin e ujit.<br>▪ Ngritja e shkallës së pagesave për furnizimin me ujë. | ▪ **PO**<br>▪ **PO** | ▪ Arkëtimi për pagesat ujore është rritur substancialisht në vitin 2021 kur janë arkëtuar të hyra në lartësi 1.5 mil | Progres substancial. |

| Masa | Veprimet e planifikuara | Zbatimi | Veprimet e ndërmarra | Progresi i vlerësuar |
|---|---|---|---|---|
| **shkallës së mospagesës për shfrytëzimin e ujit nën 5%.** | ▪ Ngritja e shkallës së pagesave për ujitje. | ▪ **PO** | EUR, krahasuar me vitin 2020 kur janë arkëtuar 0.6 mil/ EUR dhe sidomos krahasuar me vitin 2019 kur janë arkëtuar 0.2 mil. EUR.<br>▪ Shkalla e arkëtimit të faturave për shërbimet e ujit është rritur në 96% në vitin 2021.<br>▪ Shkalla e arkëtimit të KU “Radnoqi-Dukagjini”: 90-98%, KU “Drini i Bardhë”: 79%. | |
| **Masa 1.5: Të integrohen sistemet lokale dhe rurale të furnizimit me ujë në KRU.** | ▪ Zhvillimi i planit të veprimit për integrimin e sistemeve lokale dhe rurale.<br>▪ Implementimi i Planit të veprimit për integrimin e sisteme lokale dhe rurale. | ▪ JO<br>▪ JO | ▪ Nuk janë hartuar planet e veprimit nga KRU-të dhe komunat për integrimin e sistemeve rurale në KRU.<br>▪ Në kuadër të projektit RWSSP-VI të financuar nga qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës në vlerë 15.75 milion EUR janë rehabilituar dhe integruar një numër i sistemeve rurale dhe komunale të ujësjellësit.<br>▪ Deri në vitin 2021 janë integruar gjithsej 184 sisteme rurale në KRU. Kanë mbetur pa u integruar edhe mbi 100 sisteme rurale. | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 1.6: Arritja e përputhshmëris ë me Direktivën Evropiane për Ujë të Pijshëm.** | ▪ Modernizimi i laboratorëve të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit.<br>▪ Përmirësimi i impianteve të trajtimit të ujit të pijshëm.<br>▪ Përmirësimet në mbrojtjen e burimeve.<br>▪ Përmirësimi i performancës së rrjeteve ekzistuese të furnizimit.<br>- Riparimi i rrjeteve të vjetëruara<br>- Instalimi i matësve zonal të prurjes<br>- Instalimi i ujëmatësve te konsumatorët | ▪ **PO**<br>▪Pjesërisht<br>▪ **PO**<br>▪Pjesërisht | ▪ Dy prej shtatë KRU-ve i kanë laboratorët e akredituar, të tjerat i kanë laboratorët por janë në proces të akreditimit.<br>▪ Është miratuar nga MMPHI Udhëzimi Administrativ për Zonat e Mbrojtura Sanitare të Burimeve të në vitin 2017.<br>▪ Është miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2021 Udhëzimi Administrativ për Cilësinë e Ujit të Pijshëm me të cilin janë transpozuar direktivat relevante të BE-së.<br>▪ Është marrë vendimi nga MMPHI për ndalimin e transportit të materieve të rrezikshme në rrugën afër liqenit të Badovcit.<br>▪ Shkalla e përputhshmërisë së mostrave të testuara për cilësinë e ujit të pijshëm që furnizohet nga sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU-të është mbi 98%. | Progres substancial. |
| **Masa 1.7:**<br>**Programi investues për sistemin e furnizimit me ujë (24.7 mil. EUR për** | ▪ Renovimi i sistemeve të ujësjellësit, me qëllim që deri në vitin 2024, të:<br>- Ngritet shkalla e mbulueshmërisë me sistem publik të ujësjellësit në 100% në zonat *urbane*.<br>- Ngritet mbulueshmëria me sistem publik të ujësjellësit në 90% në zonat *rurale.* | ▪Pjesërisht<br>zona urbane 99.15%<br>zonat rurale: 66.7% | ▪ Janë investuar në total rreth 129 milion EUR si vijon:<br>- Është zbatuar faza e VI-të e programit RWSSP për sistemet rurale në bashkëfinancim të Qeverisë së Kosovës me Qeverinë Zvicerane në vlerë 15.75 mil EUR.<br>- Përmes KRU-ve (nga të hyrat vetanake dhe grantet) | Progres substancial. |

| Masa | Veprimet e planifikuara | Zbatimi | Veprimet e ndërmarra | Progresi i vlerësuar |
|---|---|---|---|---|
| **periudhën 2017-2021)** | - Përmirësohet trajtimi i ujërave për arritjen e përputhshmërisë me standardet e BE-së. | | janë investuar 88.5 mil EUR.<br>- Përmes komunave janë investuar rreth 20 mil EUR.<br>- Përmes MMPHI janë investuar rreth 5 mil EUR. | |
| **Masa 1.8: Optimizimi i mbulueshmërisë me sistem për ujitje.** | ▪ Përgatitja e planeve investive nga Kompanitë e Ujitjes.<br>▪ Implementimi i planeve biznesore të zhvillimit të Kompanive të Ujitjes.<br>▪ Investimet në Sistemin e Ujitjes (2017-2022: 23.21 milion EUR) | ▪ **PO**<br>▪ **PO**<br>▪ JO | ▪ Është hartuar Masterplani i Ujitjes ku janë identifikuar nevojat dhe projektet e ujitjes.<br>▪ Investimet e realizuara (rreth 3.5 milion EUR):<br>-KU "Radoniqi-Dukagjini": 2021-2022 – 3,176,629 EUR<br>-KU "Drini i Bardhë": 2017-2018 – 313,000 EUR | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 1.9: Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujit nga shfrytëzues tjerë.** | ▪ Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për turizëm dhe rekreacion.<br>▪ Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për ferma të peshqve.<br>▪ Përgatitja e një strategjie për shfrytëzimin e qëndrueshëm të inerteve nga pellgjet lumore.<br>▪ Dhënia e lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale duke respektuar nevojat dhe të drejtat e shfrytëzuesve që gjenden në rrjedhën e poshtme | ▪ JO<br>▪ JO<br>▪ JO<br>▪ JO | ▪ Nuk është hartuar një plan afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për ferma të peshqve nga MBPZHR dhe MMPHI.<br>▪ Nuk është hartuar një plan afatgjatë për shfrytëzim të ujit për turizëm dhe rekreacion nga MINT dhe MMPHI.<br>▪ Nuk është hartuar një strategji për shfrytëzim të qëndrueshëm të aluvioneve të lumenjve nga MZHE dhe MMPHI.<br>▪ MMPHI ka kryer rishikimin e lejeve të lëshuara për hidrocentrale të vogla dhe janë dhënë rekomandimet për të ardhmen. | Pa progres. |
| **Masa 1.10: Plani për menaxhimin e thatësirave.** | ▪ Masat Ligjore dhe Institucionale për Menaxhimin e Thatësirave<br>*[Udhëzim administrativ për monitorimin dhe menaxhimin e thatësirave;<br>Përcaktimi i përgjegjësive institucionale;<br>Masat për koordinim ndërkombëtar]*<br>▪ Planet e Menaxhimit të Thatësirave.<br>▪ Sistemi i Paralajmërimit të Thatësirave. | ▪ Pjesërisht<br>▪ **PO**<br>▪ **PO** | ▪ KRU-të i kanë hartuar planet e tyre të menaxhimit të thatësirës.<br>▪ MMPHI nuk e ka hartuar ende një plan kombëtar për menaxhimin e thatësisë. | Progres i pjesshëm. |
| **OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MBROJTJA E UJËRAVE**<br>***"Rregullimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve që bëjnë presion në mjedisin ujor në mënyrë proporcionale, efiçente dhe efektive që të arrihen objektivat mjedisore në mënyrë të arsyeshme ekonomike për trupat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe në të njëjtën kohë të respektohen parimet e menaxhimit të qëndrueshëm."*** | | | | |

| Masa | Veprimet e planifikuara | Zbatimi | Veprimet e ndërmarra | Progresi i vlerësuar |
|---|---|---|---|---|
| **Masa 2.1: Kontrollimi i shkarkimeve ndotëse.** | ▪ Kampanja për zbatimin e rregullave për shkarkimin e ujërave.<br>▪ Lejet për shkarkime të drejtpërdrejta nga impiantet e mëdha industriale.<br>- Regjistri i impianteve të mëdha<br>- Karakteristikat e shkarkimeve<br>- Aplikimi dhe procedimi i lejeve<br>▪ Licencimi i shkarkuesve indirekt.<br>▪ Programi i Vlerësimit të Lejeve për Shkarkimin e Ujërave. | ▪ JO<br>▪Pjesërisht<br>▪ JO<br>▪ JO | ▪ MMPHI nuk e ka krijuar ende një regjistër të plotë të shkarkimeve të ujërave të ndotura më trupat ujorë nga objektet e mëdha industriale me karakteristikat e shkarkimeve. Prej 6 subjekteve të mëdha industriale, 3 nuk kanë leje, 2 kanë leje të integruar dhe vetëm 1 ka leje ujore:<br>- (Trepça – SH.A S`ka leje<br>- New Co - Ferronikeli Ka leje të integruar<br>- Kek - SH.A Ka apliku për leje ujore<br>- Sharrcem - SH.P.K Ka leje të integruar<br>- F.P.K - Deve Ka leje ujore<br>- Birra Peja – SH.A Ka apliku<br>▪ KRU-të nuk i kanë kompletuar regjistrat për shkarkimet e ujërave të ndotura industriale në kanalizimin publik.<br>▪ Është miratuar nga MMPHI *Udhëzimi i ri Administrativ nr. 02/2022 për Vlerat Kufizuese të Shkarkimeve të Ujërave të Ndotura në Trupat Ujorë dhe në Kanalizimin Publik* me të cilin është transpozuar *Direktiva Nr. 91/271/EEC për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane.* | Progres i vogël. |
| **Masa 2.2: Zgjerimi i mbulueshmërisë me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura.** | ▪ Investimet nga Qeveria dhe donatorët në ndërtimin e sistemeve të grumbullimit të ujërave të ndotura.<br><u>Shënim:</u><br>*Në dokumentin e Strategjisë nuk janë specifikuar veprimet e planifikuara.* | ▪Pjesërisht | ▪ Mbulueshmëria me sisteme publike të grumbullimit të ujërave të ndotura ka arritur në 75% të popullsisë – prej tyre 65% menaxhohen nga KRU-të (në zonat urbane 97% ndërsa në zonat rurale 46%)<br>▪ Në periudhën 2018-2020 janë zbatuar 8 projekte përmes MMPHI me të cilat janë ndërtuar sistemet e kanalizimit për 30 fshatra. | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 2.3: Përmirësimi dhe ruajtja e funksionalitetit të sistemeve ekzistuese të grumbullimit të ujërave të ndotura.** | ▪ Investimet nga Qeveria dhe donatorët në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të grumbullimit të ujërave të ndotura.<br><u>Shënim:</u><br>*Në dokumentin e Strategjisë nuk janë specifikuar veprimet e planifikuara.* | ▪Pjesërisht | ▪ Janë zbatuar projektet e mbështetura nga KfW në Prizren, Pejë dhe Gjakovë në vlerë totale 17.5 mil. EUR;<br>▪ Është kompletuar studimi i fizibilitetit për sistemin e kanalizimit ë rajonit të Prishtinës mbështetur nga KfW.<br>▪ Është në përgatitje projekti për përmirësimin e sistemit të kanalizimit në rajonin e Prishtinës (komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Podujevë) mbështetur nga KfW në vlerë rreth 70 milion EUR. | Progres i pjesshëm. |

| Masa | Veprimet e planifikuara | Zbatimi | Veprimet e ndërmarra | Progresi i vlerësuar |
|---|---|---|---|---|
| **Masa 2.4: Implementimi i trajtimit të ujërave të ndotura.** | ▪ Investimet nga Qeveria dhe donatorët në trajtimin e ujëfrave të ndtura urbane.<br>Shënim:<br>*Në dokumentin e Strategjisë nuk janë specifikuar veprimet e planifikuara.* | ▪ **PO** | ▪ Përqindja e ujërave të ndotura që trajtohen është rritur nga 1% në 11%.<br>▪ Janë finalizuar dhe janë lëshuar në funksion impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën.<br>▪ Janë në fazën e planifikimit dhe projektimit impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Prishtinën, Gjilanin dhe Mitrovicën (këto impiante planifikohet të kompletohen deri në vitin 2026).<br>▪ Është ndërtuar impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në fshatin Orllan me qëllim të mbrojtjes së akumulimit të Batllavës. | Progres substancial. |
| **Programi i investimeve për menaxhimin e ujërave të ndotura**<br>**(46.2 mil. EUR, 2017-2021)** | ▪ Investimet e planifikuara 2017-2021: 46 milion EUR. | ▪ **PO** | ▪ Janë kryer investime në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në vlerë mbi 60 milion EUR (ITUN për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën).<br>▪ Janë zgjidhur modalitetet e investimit për implementimin e investimeve në trajtimin e ujërave të ndotura në vlerë rreth 150 mil. EUR (ITUN për Prishtinën, Mitrovicën dhe Gjilanin). | Progres substancial. |
| **Masa 2.6: Menaxhimi i llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura.** | ▪ Përgatitja e strategjisë shtetërore për menaxhimin dhe largimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura.<br>▪ Investimet që kanë të bëjnë me strategjinë e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura. | ▪Pjesërisht<br>▪ JO | ▪ Është iniciuar hartimi i planeve për menaxhimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura me vendim të Këshillit Ndërministror për Ujëra – Operatorët e impianteve të ujërave të ndotura (KRU-të) duhet t`i hartojnë ato deri në fund të vitit 2022. | Progres i vogël. |
| **Masa 2.7: Menaxhimi i ndotjes difuzive nga bujqësia.** | ▪ Udhëzues për prodhuesit bujqësorë – përdorimi i plehrave organike.<br>▪ Udhëzimet për Prodhuesit Bujqësorë – Përdorimi i Biocideve. | ▪ JO<br>▪ JO | ▪ Nuk ka pasur asnjë progres: nuk janë hartuar udhëzimet për përdorimin e plehrave në bujqësi e as udhëzimet për përdorimin e biocideve nga MBPZHR. | Pa progres. |
| **Masa 2.8: Ulja e ndotjeve difuzive nga burimet jo-** | ▪ Regjistri i tokave të kontaminuara:<br>- Identifikimi i zonave më të kontaminuara<br>- Përgatitja e hartave | ▪ JO | ▪ Nuk ka pasur asnjë progres: nuk është përgatitur nga MMPHI regjistri i tokave të kontaminuara e as strategjia për rehabilitimin e tokave të kontaminuara. | Pa progres. |

| Masa | Veprimet e planifikuara | Zbatimi | Veprimet e ndërmarra | Progresi i vlerësuar |
|---|---|---|---|---|
| **bujqësore** | - Publikimi<br>▪ Plani dhe Strategjia për Rehabilitimin e Tokave të Kontaminuara.<br>▪ Menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale – i menjëhershëm. | ▪ JO | | |
| **OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: MBROJTJA NGA UJËRAT**<br>***“Të arrihet niveli i pranueshëm i mbrojtjes së popullatës dhe pronave nga efektet negative të ujit duke përfshirë vërshimet, erozionin dhe vërshimet në mënyrë të balancuar ekonomike dhe kosto-efektive.”*** | | | | |
| **Masa 3.1: Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga vërshimet.** | ▪ Krijimi i një sistemi të mbledhjes, verifikimit dhe publikimit të të dhënave.<br>▪ Përgatitja e Planeve të para të Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet (këtu përfshihen hartat e rrezikut dhe hartat e rrezikshmërisë nga vërshimet).<br>▪ Mbështetja për zbatimin e Planeve për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet.<br>▪ Sistemi për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës për parandalimin e vërshimeve. | ▪ Pjesërisht<br>▪ JO<br>▪ JO<br>▪ JO | ▪ Në vitin 2021 është filluar projekti për përgatitjen e hartave të rrezikut nga përmbytjet për të gjitha pellgjet lumore të Kosovës, të cilat janë kompletuar në vitin 2022. Vlera e projektit 2.5 mil. EUR.<br>▪ Në vitin 2020 është kryer vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet, projekt i financuar nga donatorët në vlerë 0.6 mil. EUR.<br>▪ Planet e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet nuk janë kompletuar ende (sipas Strategjisë është dashur të kompletohen në vitin 2019). Nuk ka sistem për mirëmbajtjen e rregulltë dhe prevetive të infrastrukturës për mbrojtje nga vërshimet. | Progres i vogël. |
| **Masa 3.2: Paralajmërimi i vërshimeve dhe menaxhimi i emergjencave.** | ▪ Sistemi i monitorimit dhe paralajmërimit të rrezikut nga vërshimet<br>*[Sistemi përfshin: (i) përgatitjen e sistemit shtetëror për paralajmërimin e vërshimeve të bazuar në ISR (ii) monitorimin e sistemit rajonal të paralajmërimit për vërshime bazuar në MeteoAlarm (iii) monitorimin e statusit të vërshimeve dhe lëshimi i paralajmërimeve sipas nevojës (iv) regjistrimin në forumin EFAS dhe monitorimi në baza të rregullta.]*<br>▪ Menaxhimi i emergjencave të vërshimeve<br>*[(i) Procedurat në rast emergjence, (ii) Prokurimi i pajisjeve, (iii) Trajnimi]* | ▪ Pjesërisht<br>▪ Pjesërisht | ▪ Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës e ka krijuar sistemin e paralajmërimit të hershëm të përmbytjeve përmes SPI. Ky sistem duhet të avancohet dhe të lidhet me MeteoAlarm.<br>▪ Procedurat për veprim në rast të vërshimeve janë përcaktuar me *UA nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave*. | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 3.3: Infrastruktura për** | ▪ Investimet në Infrastrukturën për Mbrojtje nga Vërshimet– Faza 1<br>*[Rehabilitimi i strukturave ekzistuese për mbrojtje nga* | ▪ **PO** | ▪ Në periudhën 2017-2021 janë realizuar investime të konsiderueshme përmes MMPHI dhe në bashkëfinancim me komunat në rregullimin e lumenjve – 33 projekte. Këto | Progres i vogël. |

| Masa | Veprimet e planifikuara | Zbatimi | Veprimet e ndërmarra | Progresi i vlerësuar |
|---|---|---|---|---|
| **parandalimin dhe mbrojtjen nga vërshimet.** | *vërshimet. Implementimi i projekteve të gatshme për investime për infrastrukturën e re për parandalimin e vërshimeve]*<br>▪ Sistemi i Drenazhimit Urban (Kanalizimi i ujërave atmosferike në zonat urbane).<br>▪ Investimet në infrastrukturën për mbrojtje nga vërshimet – Faza 2<br>*[Implementimi i masave dhe projekteve të përcaktuara me prioritet me Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet]* | ▪ JO<br>▪ JO | investime tejkalojnë investimet e parapara me Strategji për këtë qëllim në periudhën 2017-2021 në vlerë 4.3 mil. EUR.<br>▪ Asnjë komunë nuk ka plan për drenazhimin urban – sistemin e kanalizimit atmosferik.<br>▪ Investimet e fazës 2 bazuar në Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet nuk kanë mundur të implementohen duke pasur parasysh se ky plan nuk është kompletuar ende. | |
| **Masa 3.4: Sigurimi që të gjitha strukturave ekzistuese akumuluese janë të sigurta.** | ▪ Sistemi i menaxhimit të sigurisë së digave.<br>▪ Renovimi i digave ekzistuese dhe akumulimeve | ▪**PO**<br>▪Pjesërisht | ▪ MMPHI ka zbatuar një projekt për vlerësimin e sigurisë së digave dhe rrezikun sizmik i cili është zbatuar në vitin 2021-2022. Në kuadër të këtij projekti janë trajnuar personeli i KRU-ve për sigurinë e digave.<br>▪ Në vitin 2018 është rehabilituar diga e Përlepnicës.<br>▪ MMPHI ka hartuar *Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2017 për Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave* me të cilin janë përcaktuar përgjegjësitë institucionale për operimin dhe mirëmbajten e digave si dhe standardet e projektimit dhe ndërtimit. | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 3.5: Menaxhimi i erozionit dhe rrëkeve.** | ▪ Përgatitja e Planeve për menaxhimin e rrëkeve dhe erozionit.<br>▪ Implementimi i Planeve për Menaxhimin e Rrëkeve dhe Erozionit. | ▪ JO<br>▪ JO | ▪ Nuk ka pasur progres. | Pa progres. |
| **OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: QEVERISJA**<br>***"Krijimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të qeverisjes me ujërat që është i drejtë, transparent, efiçent, i koordinuar dhe me kapacitete të tilla profesionale dhe teknike që të jetë në gjendje të mbështesë në mënyrë efiçiente arritjen e objektivave strategjike"*** | | | | |
| **Masa 4.1: Legjislacioni për menaxhimin mjedisor të ujërave.** | ▪ Vlerësimi i kostos së përputhshmërisë së legjislacionit të propozuar.<br>- *Vlerësimi fillestar i Kostos së Zbatimit (i thjeshtuar)*<br>- *Përcaktimi i rëndësisë së kostove*<br>- *Vlerësimi i detajuar nëse konstatohet se kostot janë të* | ▪Pjesërisht<br>▪ JO | ▪ Miratimi i secilit akt nënligjor përcillet me vlerësimin e kostove për zbatim.<br>▪ Janë hartuar dhe miratuar një numër i konsiderueshëm i akteve nënligjore që kërkohen sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës - gjashtë në periudhën 2017-2021. | Progres i vogël. |

| Masa | Veprimet e planifikuara | Zbatimi | Veprimet e ndërmarra | Progresi i vlerësuar |
|---|---|---|---|---|
| | *rëndësishme*<br>- *Analiza e ndjeshmërisë: standardet kundrejt kostos*<br>▪ Vlerësimi i ndikimit rregullator nga legjislacioni i propozuar.<br>▪ Mbështetja për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e ujërave:<br>*[(i) Publikimi i legjislacionit – baza e plotë e të dhënave në internet, (ii) Procedura e shpërndarjes – reklama, njoftime, (iii) Tekste shpjeguese për të gjitha instrumentet ligjore, (iv) Udhëzues dhe këshilla teknike për të gjitha palët e interesit]* | ▪ JO | ▪ Nuk është hartuar një vlerësim i plotë i kostove për zbatimin e legjislacionit ujor dhe transpozimit të direktivave të ujit.<br>▪ Nuk është kompletuar një sistem për mbështetje të zbatimit të legjislacionit që do të përfshinte udhëzuesit për zbatimin e të gjitha akteve normative. | |
| **Masa 4.2: Tranzicioni drejt transpozimit të legjislacionit të BE.** | ▪ Transpozimi i procesit ë planifikimit të menaxhimit të ujërave.<br>▪ Transpozimi i objektivave afatgjata për menaxhimin e ujërave.<br>▪ Përcaktimi i Objektivave Kalimtare. | ▪ **PO**<br>▪ **PO**<br>▪Pjesërisht | ▪ Me Ligjin për Ujëra dhe aktet nënligjore të miratuara nga MMPHI gjatë periudhës 2017-2019 është tranpozuar procesi i planifikimit të menaxhimit të resurseve ujore (PMPL, Planet e Vërshimeve, afatet dhe përmbajtja etj.).<br>▪ Përmes Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore që janë në proces të hartimit, janë duke u zbatuar parimet e planifikimit të menaxhimit të pellgjeve lumore, përfshirë përcaktimin e objektivave mjedisore, klasifikimin e trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, analizën e presioneve dhe programin e masave. | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 4.3: Përforcimet institucionale.** | ▪ Themelimi dhe Funksionalizimi i plotë i Autoritetit të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore.<br>▪ Përforcimi i Inspektoratit Mjedisor të Divizionit të Ujërave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.<br>▪ Përforcim substancial i Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës.<br>▪ Themelimi i Institutit për Ujërat<br>▪ Fuqizimi i ARRU për rregullimin e trajtimit të ujërave të ndotura *[4 pozita të reja]* | ▪Pjesërisht<br>▪ JO<br>▪ JO<br>▪ JO<br>▪ JO | ▪ Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) është themeluar dhe prej vitit 2017 funksionon si departament brenda MMPHI.<br>▪ Personeli i ARPL nuk është kompletuar ende sipas strukturës organizative të tij.<br>▪ Nuk ka pasur progres të duhur në fuqizimin institucional të Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK): laboratori ka mbetur i pa-akredituar, personeli nuk është rritur.<br>▪ Inspektorati Mjedisor nuk është kompletuar sipas SSHUK–nuk është rritur numri i inspektorëve me 5 inspektorë shtesë siç ishte planifikuar.<br>▪ Instituti për Ujëra nuk është themeluar. | Progres i vogël. |

| Masa | Veprimet e planifikuara | Zbatimi | Veprimet e ndërmarra | Progresi i vlerësuar |
|---|---|---|---|---|
| **Masa 4.4: Menaxhimi i informacioneve.** | ▪ Sistemi i informativ për ujërat.<br>▪ Marrëveshja dhe procedura e shkëmbimit ndër-institucional i të dhënave.<br>▪ Publikimi i të gjitha të dhënave për sektorin e ujërave përmes një portali në internet. | ▪ **PO**<br>▪ JO<br>▪Pjesërisht | Është krijuar një sistem informativ i menaxhimit të ujërave në vitin 2021, i cili duhet të zhvillohet më tutje dhe të plotësohet me të dhëna. | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 4.5: Edukimi në menaxhimin e ujërave.** | ▪ Fushata publike e ndërgjegjësimit për çështjet e ujërave.<br>▪ Të sigurohet që kurrikula shkollore të përfshijë përmbajtje të duhur që ka të bëjë me ujërat.<br>duke përfshirë:<br>- Ciklin Ujor<br>- Shfrytëzimin e Ujërave<br>- Ndotjen e Ujërave<br>- Kursimin e Ujit<br>- Parandalimin e ndotjes së ujërave<br>- Rrezikun nga vërshimet.<br>▪ Implementimi i rekomandimeve të studimit të TFU për zhvillimin akademik. | ▪ **PO**<br>▪Pjesërisht<br>▪Pjesërisht | ▪ Përmes projektit Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU) i financuar nga Qeveria e Zvicrës, publikohet buletini "Uji i Kosovës" ku jepen informacione për qëllime të ndërgjegjësimit për çështjet për ujërat.<br>▪ Përmes projektit MIRU është planifikuar dhe pritet të fillojë në vitin 2023 programi Master në menaxhimin e resurseve ujore në kuadër të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". | Progres i pjesshëm. |
| **Masa 4.6: Planifikimi për menaxhim të integruar të pellgjeve lumore** | ▪ Planet e para për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve.<br>▪ Përgatitja e Planeve të Dyta për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve.<br>▪ Ndërveprimi i dytë me Planet për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve. | ▪Pjesërisht<br>▪ JO<br>▪ JO | ▪ Plani për Menaxhimin e Pellgut të Lumit Drini i Bardhë është në fazën e finalizimit, me mbështetjen financiare nga Qeveria e Suedisë (SIDA).<br>▪ Planet për menaxhimin e tri pellgjeve tjera lumore (Lepenci, Ibri dhe Morava e Binçës) janë në fazën fillestare të planifikimit, me mbështetjen financiare të Qeverisë së Zvicrës përmes programit MIRU. | Progres i vogël. |

## Shtojca 1: Treguesit objektivisht të verifikueshëm të Strategjisë

### 1. Shfrytëzimi i ujit

a) Treguesit titullarë:

1) Mbulimi i përgjithshëm i popullsisë me furnizim publik me ujë;
2) Performanca e përgjithshme e Kompanisë së Ujit;
3) Vlera e kulturave bujqësore të ujitura si përqindje e BPV;
4) Përqindja e enegjisë e gjeneruar nga hidrocentralet.

b) Treguesit e hollësishëm

| **Ref** | **Treguesi** | **Përkufizimi** | **Mënyra e verifikimit** | **Autoriteti raportues** |
|---|---|---|---|---|
| 1.1 | Kapaciteti i shfrytëzueshëm i akumulimit të ujit për të përkrahur furnizimin e qëndrueshëm me ujë: Parandalimi i thatësirave | | | |
| 1.1a | Kapaciteti specifik i akumulimit – absolut | Vëllimi i akumulacionit ($m^3$/banor) | Regjistri i akumulacioneve | MMPHI |
| 1.1b | Kapaciteti specifik i akumulimit – relativ | Vëllimi i akumulacionit si përqindje e vitit bazë: 2015 (% i 2015) | Regjistri i akumulacioneve | MMPHI |
| 1.1c | Sasia e ujërave sipërfaqësore | Proporcioni i trupave ujorë sipërfaqësor që i nënshtrohen mungesës së ujit (dështimi për të ruajtur prurjen minimale ekologjike) | IHMK | MMPHI |
| 1.1d | Sasia e ujërave nëntokësore | Proporcioni i trupave ujorë nëntokësore që arrijnë status të mirë sasior. | IHMK | MMPHI |
| 1.1e | Kufizimet në përdorim | Numri i kufizimeve të shkaktuara nga thatësira që iu imponohen bartësve të licencave për nxjerrjen e ujërave | Departamenti i ujërave | MMPHI |
| 1.2 | Mbulueshmëria me shërbime të ujit të pijshëm në përputhje me standardet | | | |
| 1.2a | Proporcioni i popullsisë urbane me qasje në sistemin publik[4] të furnizimit me ujë | Popullsia urbane me qasje në rrjet / popullsia urbane totale (%) | Ofruesit e shërbimeve të ujit | ARRU |
| 1.2b | Proporcioni i popullsisë rurale me qasje në sistemin publik të furnizimit me ujë | Popullsia urbane me qasje në rrjet / Popullsia rurale totale (%) | Ofruesit e shërbimeve të ujit | ARRU |
| 1.2c | Proporcioni i konsumatorëve që marrin furnizim 24 orësh | Konsumatorët që marrin furnizim 24 orësh / Totali i konsumatorëve (%) | Ofruesit e Shërbimeve të Ujit | ARRU |
| 1.2d | Cilësia mikrobiologjike | Niveli i përputhshmërisë së analizave të ujit me standarde të cilësisë së ujit të pijshëm (%) | IKSHPK | ARRU |

[4] Publik në këtë kontekst i referohet furnizimeve që ofrojnë kompanitë regjionale të ujit, shërbimet komunale dhe organizatat/asociacionet e shërbimit në komunitet

| Ref | Treguesi | Përkufizimi | Mënyra e verifikimit | Autoriteti raportues |
|---|---|---|---|---|
| 1.2e | Cilësia kimike | Niveli i përputhshmërisë së analizave të ujit me standarde të cilësisë së ujit të pijshëm (%) | IKSHPK | ARRU |
| 1.3 | Mbulueshmëria me shërbimin e ujitjes | | | |
| 1.3a | Sipërfaqja e tokës nën ujitje | Hektarë | Shënimet e kompanive të ujitjes | MBPZHR |
| 1.3b | Përqindja e tokës së ujitshme nën ujitje | Toka e ujitur / Toka e ujitshme (%) | Shënimet e kompanive të ujitjes | MBPZHR |
| *1.4* | *Energjia e ripërtëritshme nga Hidrocentralet (këta tregues kanë të bëjnë më shumë me sektorin e energjisë se sa me atë të ujërave)* | | | |
| *1.4a* | *Energjia e gjeneruar – absolute* | *GWh e energjisë së gjeneruar nga hidrocentralet* | *Shënimet e ndërmarrjeve gjeneruese* | *Rregullatori i Energjisë* |
| *1.4b* | *Energjia e gjeneruar – relative* | *% e totalit të energjisë së gjeneruar nga hidrocentralet* | *Shënimet e ndërmarrjeve gjeneruese* | *Rregullatori i Energjisë* |
| 1.5 | Aplikimi i parimit "ndotësi paguan" | | | |
| 1.5a | Humbjet administrative të ujit | % e ujit të prodhuar që humb për shkak të lidhjeve ilegale, vjedhjes së ujit, konsumi i pamatur dhe regjistrimi më i ulët nga ujëmatësit | Ofruesit e shërbimeve të ujit | ARRU |
| 1.5b | Shkalla e arkëtimit – shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm | % e faturave të paguara me kohë (%) | Ofruesit e shërbimeve të ujit | ARRU |
| 1.5c | Shkalla e arkëtimit – furnizimi i ujit me shumicë duke përfshirë ujitjen | % e faturave të paguara me kohë (%) | Shënimet e kompanive të ujërave | MBPZHR |
| 1.5d | Nxjerrjet pa licencë | Proporcioni i ujërave të nxjerra për të cilin nuk janë dhënë licencat (%) | Inspektorati i ujërave | MMPHI |
| 1.5e | Norma e arkëtimit (mbledhja) taksat e nxjerrjes | % e faturave të paguara me kohë (%) | Shënimet e Departamentit të Ujërave | MMPHI |
| 1.6 | Efiçienca e shfrytëzimit | | | |
| 1.6a | Uji i pa-faturuar: Furnizimi me ujë të pijshëm | % ujit të pa – faturuar krahasuar me prodhimin total (%): Uji i pijshëm | Ofruesit e shërbimeve të ujit | ARRU |
| 1.6b | Uji i pa-faturuar: Furnizimi i ujit me shumicë | % ujit të pa-faturuar krahasuar me prodhimin total (%): Uji me shumicë | Furnizuesit me shumicë të ujit | MZHE |
| 1.6c | Uji i pa-faturuar: Ujitja | % ujit i pa-faturuar krahasuar me prodhimin total (%): Ujitja | Kompanitë e ujitjes | MBPZHR |

| Ref | Treguesi | Përkufizimi | Mënyra e verifikimit | Autoriteti raportues |
|---|---|---|---|---|
| 1.6d | Vlera e shtuar nga ujitja e bimëve – absolute | Prodhimet bimore nga tokat e ujitura: Euro në vit (€) | Llogaritë ekonomike për bujqësi | MBPZHR<br>ASK |
| 1.6e | Vlera e shtuar nga ujitja e bimëve – relative | Prodhimet bimore nga tokat e ujitura: Euro në vit / vëllimi i ujit të përdorur për ujitje (€/m3) | Llogaritë ekonomike për bujqësi | MBPZHR<br>ASK |
| 1.6f | Kontributi i sektorit të ujërave në BPV | % e Bruto Produktit Vendor që vie si rezultat i sektorit të ujërave (duke përjashtuar hidrocentralet) | Agjencia e Statistikave të Kosovës | MZHE |

## 2. Mbrojtja e ujërave

a) Treguesit titullarë:

1) Mbulueshmëria e përgjithshme e popullatës me sistemin e kanalizimit të ujërave të ndotura

2) Performanca e përgjithshme e shërbimeve të Kompanive të ujërave – shërbimet e kanalizimit

3) Cilësia e ujërave sipërfaqësore: % që arrijnë objektivat mjedisore (duke përfshirë gjendjen e mirë ekologjike)

1. Treguesit e hollësishëm

| Ref | Treguesi | Përkufizimi | Mënyra e verifikimit | Autoriteti raportues |
|---|---|---|---|---|
| 2.1 | Cilësia e ujërave sipërfaqësore | | | |
| 2.1a | Cilësia fiziko-kimike[5] | Nr. i trupave ujorë sipërfaqësorë që plotësojnë objektivat fiziko-kimik/ Nr.total i trupave ujorë sipërfaqësorë (%) | IHMK | MMPHI |
| 2.1b | Cilësia biologjike[6] | Nr. i trupave ujorë sipërfaqësorë që plotësojnë objektivat biologjike/ Nr. total i trupave ujorë sipërfaqësorë (%) | IHMK | MMPHI |
| 2.1c | Cilësia hidro-morfologjike[7] | Nr. i trupave ujorë sipërfaqësorë që plotësojnë objektivat hidro-morfologjike/ Nr. total i trupave ujorë sipërfaqësorë (%) | IHMK<br>Komunat | MMPHI |
| 2.2 | Cilësia e ujërave nëntokësore | | | |
| 2.2a | Cilësia fiziko-kimike | Nr. i trupave ujorë nëntokësorë që plotësojnë objektivat fiziko-kimike/ Nr. total i trupave ujorë nëntokësorë (%) | IHMK | MMPHI |
| 2.2b | Cilësia mikrobiologjike | Nr. i trupave ujorë nëntokësorë që plotësojnë objektivat mikrobiologjike/ Nr. total i trupave ujorë nëntokësorë (%) | IHMK | MMPHI |
| 2.3 | Menaxhimi i Ujërave të ndotura | | | |

[5] Cilësia e elementeve fiziko-kimike të gjendjes ekologjike në Shtojcën V të Direktivës Kornizë të Ujërave
[6] Cilësia e elementeve biologjike të gjendjes ekologjike në Shtojcën V të Direktivës Kornizë të Ujërave
[7] Cilësia e elementeve hidromorfologjike të gjendjes ekologjike në Shtojcën V të Direktivës Kornizë të Ujërave

| Ref | Treguesi | Përkufizimi | Mënyra e verifikimit | Autoriteti raportues |
|---|---|---|---|---|
| 2.3a | Proporcioni popullsisë urbane të kyçur në kanalizim publik | Popullsia urbane e kyçur/ Totali i popullsisë urbane (%) | Ofruesit e Shërbimeve të Ujit | ARRU |
| 2.3b | Proporcioni i popullsisë rurale të kyçur në kanalizim publik | Popullsia rurale e kyçur/ Totali i popullsisë rurale (%) | Ofruesit e Shërbimeve të Ujit | ARRU |
| 2.3c | Vetëm trajtimi primar i ujërave të ndotura (1º) | Vetëm trajtimi primar i ujërave të ndotura/ Ujërat e ndotura të gjeneruara (%) | Ofruesit e Shërbimeve të Ujit | ARRU<br>MMPHI |
| 2.3d | Trajtimi sekondar i ujërave të ndotura (2º) | Trajtimi sekondar i ujërave të ndotura / Ujërat e Ndotura të gjeneruara (%) | Ofruesit e shërbimeve të ujit | ARRU<br>MMPHI |
| 2.3e | Përputhshmëria e ujërave të ndotura urbane të shkarkuara me kushtet e licencës | Numri i mostrave të ujërave të ndotura që plotësojnë standardet / Numri i mostrave të ujërave të ndotura që janë matur (%) | Ofruesit e Shërbimeve të Ujit<br>Inspektorati<br>IHMK | MMPHI |
| 2.3f | Përputhshmëria e shkarkimeve të tjera me kushtet e licencës | Numri i mostrave tjera të ujërave të ndotura që plotësojnë standardet / Numri i mostrave të ujërave të ndotura që janë matur (%) | Inspektorati<br>IHMK | MMPHI |
| 2.3g | Shkarkimi i ujërave të ndotura pa licencë përkatëse | Numri i shkarkuesve pa licencë | Inspektorati | MMPHI |
| <u>2.4</u> | <u>Zonat e mbrojtura ujore (ZMU)</u> | | | |
| 2.4a | Mbulueshmëria e ZMU-ve | Sipërfaqja e mbuluar me vendime për ZMU ($km^2$) | Vendimet Ligjore | MMPHI |
| 2.4b | Përputhshmëria me ZMU | Inspektimet e ZMU-ve – Përputhshmëria / Inspektimet e ZMU-ve | Inspektorati | MMPHI<br>KRU-të |
| <u>2.5</u> | <u>Zbatimi i parimit "ndotësi paguan"</u> | | | |
| 2.5a | Shkalla e arkëtimit – ujërat e ndotura urbane | % e faturave të paguara me kohë (%) | Ofruesit e Shërbimeve të Ujit | ARRU |
| 2.5b | Shkalla e arkëtimit – pagesa ujore për shkarkim të ujërave | % e faturave të paguara me kohë (%) | Shënimet e Departamentit të Ujërave | MMPHI |

## 3. Mbrojtja nga ujërat

a) <u>Treguesit titullarë:</u>

1) Popullësia e ekspozuar ndaj rrezikut të lartë të vërshimeve (%)

b) Treguesit e hollësishëm

| Ref | Indikatori | Definicioni | Mënyra e verifikimit | Autoriteti raportues |
|---|---|---|---|---|
| 3.1 | Menaxhimi i Rrezikut nga vërshimet | | | |
| 3.1a | Planifikimi i Menaxhimit të Rrezikut nga vërshimet (PMRP) | Sipërfaqja e vendit që është mbuluar me plane për vlerësimin e rrezikut nga vërshimet / Sipërfaqja e vendit (%) | Shënimet e MMPHI Shënimet e Komunave | MMPHI |
| 3.1b | Mbrojtja nga Rreziku i Vërshimeve - Urbane | Zona urbane me rrezik të lart për vërshime ($km^2$) | Zbatimi i PMRP | MMPHI<br>IHMK |
| 3.1c | Mbrojtja nga Rreziku i Vërshimeve – Jourbane | Zona jo-urbane me rrezik të lartë për vërshime ($km^2$) | Zbatimi i PMRP | MMPHI<br>IHMK |
| 3.1d | Dëmtimet nga Vërshimet | Parashikimi i dëmeve ekonomike nga vërshimet (€) | Parashikim i W.I. | MMPHI |
| 3.2 | Siguria e Digave | | | |
| 3.2a | Siguria e Digave - Inspektimi | Niveli i përputhjes me standardet (inspektimet) (%) | Shënimet e Inspektimeve nga MZHE | MMPHI |
| 3.3 | Erozioni | | | |
| 3.3a | Përputhshmëria e zonave të erozionit | Zbatimi i masave lehtësuese për Zonat e erozionit (sipërfaqja) / Totali i zonave të përcaktuara erozive (%) | Inspektorati i MMPHI | MMPHI<br>Komunat |

## 4. Qeverisja

a) Treguesit titullarë:

1) Përparimi në zbatimin e programit të masave
2) Investimet Kapitale në sektorin e ujërave – krahasimore

b) Treguesit e hollësishëm:

| Ref | Indikatori | Definicioni | Mënyra e Verifikimit | Autoriteti Raportues |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Niveli i transponimit të legjislacionit të BE-së | | | |
| 4.1a | Niveli i transponimit | Tabelat e përputhshmërisë | MMPHI | MMPHI |
| 4.2 | Plani i Menaxhimit të Pellgjeve Lumore | | | |

| Ref | Indikatori | Definicioni | Mënyra e Verifikimit | Autoriteti Raportues |
|---|---|---|---|---|
| 4.2a | Plani Menaxhues për Pellgjet lumore | Sipërfaqja e vendit e mbuluar plotësisht me Planin menaxhues për pellgjet lumore / Sipërfaqja e vendit (%) | Shënimet e MMPHI | MMPHI |
| 4.2b | Programi i masave | Vlera e masave të ndërmarra / Vlera e masave në program (%) | MMPHI | MMPHI |
| 4.3 | Intensiteti i monitorimit mjedisor | | | |
| 4.3a | Inspektimet | Numri i inspektimeve të ndërmarra | Inspektorati | MMPHI |
| 4.3b | Efiçienca e inspektimeve | Numri mesatar i inspektimeve për inspektor | Inspektorati | MMPHI |
| 4.3c | Monitorimi i ujërave sipërfaqësore | • Nr. pikave të monitorimit<br>• Nr. mostrave të marra<br>• Nr. i parametrave të analizuara | IHMK | MMPHI |
| 4.3d | Monitorimi i ujërave nëntokësore | • Nr. pikave të monitorimit<br>• Nr. mostrave të marra<br>• Nr. i parametrave të analizuara | IHMK<br>IKSHPK | MMPHI |
| 4.3e | Monitorimi i shkarkimeve | Mostrat e marra dhe të analizuara | Inspektorati | MMPHI |
| 4.4 | Zbatimi | | | |
| 4.4a | Frekuenca e zbatimit | Numri i aksioneve të ndërmarra për zbatimin e ligjit | Inspektorati | MMPHI |
| 4.4b | Gjobat dhe dënimet | Vlera totale e dënimeve të shqiptuara dhe gjobave të vëna | Inspektorati | MMPHI |
| 4.5 | Qasja në informata | | | |
| 4.5a | Publikimi i të dhënave | Të dhënat e publikuara për prodhimin e ujit / Të dhënat për sektorin e ujërave | Shënimet e MMPHI | MMPHI |
| 4.5b | Qasja në të dhëna | Numri i klikimeve të regjistruara në KED faqen e ujërave | | |
| 4.6 | Investimet | | | |
| 4.6a | Investimet Kapitale në sektorët e ujërave dhe kanalizimeve – absolute | Vlera Absolute (€) | Baza e të dhënave të projektit | MZHE<br>ARRU |
| 4.6b | Investimet Kapitale në sektorët e ujërave dhe kanalizimeve - relative | Në raport me planin (% e zbatimit) | Baza e të dhënave të projektit | MZHE<br>ARRU |
| 4.6b | Investimet Kapitale në sektorët e ujërave dhe kanalizimeve – krahasimore | Në raport me BPV (%) | Baza e të dhënave të projektit | MZHE<br>ARRU |

## Shtojca 2: Pyetësorët për institucionetorganizatat që kanë rol në zbatimin e Strategjisë

### 1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës/Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore

**Pyetësori për MMPHI/ARPL**
**Lidhur me zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra**

*Sqarim hyrës:*
*Pyetjet e formuluara në këtë pyetësor janë bazuar në treguesit objektivisht të verifikueshëm të përcaktuar në Strategjinë Shtetërore për Ujëra për monitorimin e progresit në zbatimin e kësaj Strategjie.*

### OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHFRYTËZIMI I UJËRAVE

1. **Sa është vëllimi i akumulacionit ($m^3$/banor)?**
2. **A është hartuar studimi i fizibilitetit për akumulimet e ujit në të gjitha pellgjet lumore?**
   *Sqarim: Ky studim është dashur të kompletohet deri në vitin 2019.*
3. **A është hartuar dokumentacioni teknik dhe tenderues për projektet prioritare për akumulimet e reja të ujit?**
   *Sqarim: Ky punë është dashur (sipas Strategjisë) të kryhet deri në vitin 2021.*
4. **Sa është numri i kufizimeve të shkaktuara nga thatësira që iu imponohen bartësve të licencave për nxjerrjen e ujërave?**
   *Sqarim: nëse ka pasur kufizime të imponuara nga ARPL për shfrytëzuesit e ujit në rast të thatësisë.*
5. **Sa është proporcioni i ujërave të nxjerra për të cilin nuk janë dhënë leje (%)?**
   *Sqarim: nëse ka të dhëna për sasitë e shfrytëzuara të ujit pa leje ujore.*
6. **Sa është përqindja e pagesave ujore për shfrytëzim të ujit të paguara me kohë (%)?**
   *Sqarim: Pyetja ka të bëj me pagesat ujore të paguara në afatin e përcaktuar.*
7. **A është hartuar plani afatgjatë për turizëm dhe rekreacion?**
   *Sqarim: Kjo pyetje të diskutohet edhe me MINT.*
8. **A është hartuar plani afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për ferma të peshqve?**
   *Sqarim: Kjo pyetje të diskutohet edhe me MBPZHR.*
9. **A është hartuar strategjia për shfrytëzimin e qëndrueshëm të inerteve nga pellgjet lumore?**
   *Sqarim: Strategjia ka qenë planifikuar të hartohet deri në vitin 2018.*
10. **A janë respektuar nevojat dhe të drejtat e shfrytëzuesve që gjenden në rrjedhën e poshtme me rastin e dhënies së lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale?**
11. **A e ka hartuar MMPHI Planin e Menaxhimit të Thatësisë?**
12. **A ka sistem të Pralajmërimit të Hershëm të Thatësisë?**
13. **Sa shfrytëzues të ujit pa leje ujore janë gjetur nga inspekcioni prej vitit 2017 dhe çfarë masa janë ndërmarrë kundër tyre? (gjobitje, pajisje me leje ujore etj.)**

### OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MBROJTJA E UJËRAVE

1. **Çfarë aktivitete i ka zhvilluar Ministria për zbatimin e rregullave ligjore për shkarkimin e ujërave?**
2. **Sa shkarkues të ujërave të ndotura pa leje ujore janë gjetur nga inspekcioni prej vitit 2017 dhe çfarë masa janë ndërmarrë kundër tyre? (gjobitje, pajisje me leje ujore etj.)**

3. **Sa është numri i lejeve ujore të lëshuara prej vitit 2017 nga MMPHI për shkarkimin e ujërave të ndotura industriale në trupa ujorë?**

4. **Sa është numri i lejeve ujore të lëshuara nga MMPHI për shkarkimin e ujërave të ndotura industriale në kanalizimin publik?**

5. **A është bërë vlerësimi i efekteve të shkarkimeve individuale të ujërave të ndotura i ndustriale ne mjedisin ujor dhe çfarë masa janë ndërmarrë?**

6. **Sa është numri i mostrave të ujërave të ndotura urbane që plotësojnë standardet në raport me numrin e mostrave të ujërave të ndotura që janë analizuar/matur (%)?**
   *Sqarim: nëse janë analizuar cilësia e ujërave të ndotura urbane para shkarkimit të tyre në trup ujor.*

7. **Sa është numri i mostrave të ujërave të ndotura jourbane (industriale) që i plotësojnë standardet në raport me numrin e mostrave të ujërave të ndotura që janë matur (%)?**
   *Sqarim: nëse ka të dhëna për cilësinë e ujërave të ndotura jo-urbane/industriale para shkarkimit të tyre në trup ujor.*

8. **Sa është sipërfaqja e mbuluar me vendime për Zonat e Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit ($km^2$)?**
   *Sqarim: Nëse është përllogaritur sipërfaqja e Sa është sipënëse janë analizuar cilësia e ujërave të ndotura para shkarkimit të tyre në trup ujor.*

9. **Sa është numri i burimeve të ujit për të cilët prej vitit 2017 janë nxjerrë vendime për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare?**

10. **Sa është numri i inspektimeve të zonave të mbrojtura sanitare të burimeve të ujit? Në sa prej inspektimeve është konstatuar përputhshmëria me masat mbrojtëse?**

11. **Sa është përqindja e pagesave ujore për shkarkimin e ujërave të paguara me kohë (%)?**

12. **A është hartuar Strategjia për Menaxhimin e Llumit nga kanalizimi i ujërave të ndotura?**

13. **A janë idnetifikuar dhe a është hartuar regjistri i tokave të kontaminuara?**

14. **A është hartuar Plani dhe Strategjia për Rehabilitimin e Tokave të Kontaminuara?**

15. **A është hartuar Strategjia/Plani për menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale?**

16. **Sa është numri i trupave ujorë sipërfaqësorë që plotësojnë objektivat fiziko-kimik në raport e numrin total të trupave ujore sipërfaqësore (%)?**
    *Sqarim: Përgjigjja duhet të rezultojë nga monitorimi i parametrave fiziko-kimikë të trupave ujorë sipërfaqësor të cilët shërbejnë për përcaktimin e statusit të mirë ekologjik.*

17. **Sa është numri i trupave ujorë sipërfaqësorë që plotësojnë objektivat biologjike në raport me numrin total të trupave ujore sipërfaqësore (%)?**
    *Sqarim: Përgjigjja duhet të rezultojë nga monitorimi i parametrave biologjike të trupave ujorë sipërfaqësor të cilët shërbejnë për përcaktimin e statusit të mirë ekologjik.*

18. **Sa është numri i trupave ujore sipërfaqësore që plotësojnë objektivat hidro-morfologjike në raport me numrin total të trupave ujore sipërfaqësore (%)?**
    *Sqarim: Përgjigjja duhet të rezultojë nga monitorimi i hidro-morfologjik i trupave ujorë sipërfaqësor të cilët shërbejnë për përcaktimin e statusit të mirë ekologjik.*

19. **Sa është numri i trupave ujorë nëntokësorë që plotësojnë objektivat fiziko-kimike në raport me numrin total të trupave ujore nëntokësore (%)?**
    *Sqarim: Kjo pyetje mund të përgjigjet nëse është monitoruar statusi kimik i trupave ujorë nëntokësorë.*

20. **Sa është numri i trupave ujore nëntokësore që plotësojnë objektivat mikrobiologjike në raport me numrin total të trupave ujore nëntokësore (%)?**

*Sqarim: Kjo pyetje mund të përgjigjet nëse është janë monitoruar parametrat mikrobiologjikë të trupave ujorë nëntokësorë.*

## OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: MBROJTJA NGA UJËRAT

1. **A janë hartuar Planet për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet?**

2. **A është krijuar sistemi për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës së përmbytjeve?**
   *Sqarim: sistemi është planifikuar që të përfshijë: (i) regjistrin e infrastrukturës, (ii) procedurat për mirëmbajtjen e regjistrit, (iii) programin për inspektimin e infrastrukturës, (iv) programin për mirëmbajtjen e infrastrukturës.*

3. **A është krijuar sistemi për paralajmërimin e hershëm nga përmbytjet?**

4. **A ka Ministria Plan për menaxhimin e përmbytjeve?**

5. **Sa kanë qenë investimet prej vitit 2017 në infrastrukturën për mbrojtje nga përmbytjet?**

6. **A është krijuar sistem për sigurinë e digave?**
   *Sqarim: Sistemi i tillë duhet të përfshijë: përcaktimi i përgjegjësive institucionale, vendosja e sistemit të monitorimit të sigurisë së digave dhe raportimit, sistemet e alrmit.*

7. **Sa kanë qenë investimet në rehabilitimin e digave prej vitit 2017?**

8. **A janë hartuar planet për menaxhimin e rrëkeve dhe erozionit?**

9. **Sa është sipërfaqja e zonave urbane me rrezik të lart ndaj vërshimeve ($km^2$)?**
   *Sqarim: Kjo pyetje mund të përgjigjet nëse është kryer vlerësimi i rrezikut nga vërshimet.*

10. **Sa është sipërfaqja e zonave jo-urbane me rrezik të lart ndaj vërshimeve ($km^2$)?**
    *Sqarim: Kjo pyetje mund të përgjigjet nëse është kryer vlerësimi i rrezikut nga vërshimet.*

## OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: QEVERISJA

1. **A është themeluar dhe a është funksiononalizuar plotësisht Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore? Sa është aktualisht numri i stafit të ARPL?**

2. **A është fuqizuar institucionalisht Inspekcioni i Ujërave? Sa inspektor të ujërave janë shtuar prej vitit 2017?**

3. **A është fuqizuar institucionalisht Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës? Sa është numri i stafit që është shtuar prej vitit 2017?**

4. **A është themeluar Instituti për Ujëra i Kosovës?**

5. **A është krijuar dhe a është funksional Sistemi Informativ Ujor?**

6. **A i publikon Ministria të gjitha të dhënat përmes një portali në Internet?**

7. **A janë kompletuar Planet për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore?**

8. **Monitorimi i ujërave sipërfaqësore**
   - Sa është numri i pikave të monitorimit?
   - Sa është numri i mostrave të marra?
   - Sa është numri i parametrave të analizuara?

9. **Monitorimi i ujërave nëntokësore**

- Sa është numri i pikave të monitorimit?
- Sa është numri i mostrave të marra?
- Sa është numri i parametrave të analizuara?

**2. Ministria e Ekonomisë**

**Pyetësori për ME**
**Lidhur me zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra**

*Sqarim hyrës:*
*Pyetjet e formuluara në këtë pyetësor janë bazuar në treguesit objektivisht të verifikueshëm të përcaktuar në Strategjinë Shtetërore për Ujëra për monitorimin e progresit në zbatimin e kësaj Strategjie dhe në Veprimet e Planifikuara për zbatimin e masave dhe Objektivave Strategjikë.*

1. **A kanë Kompanitë Rajonale të Ujit laboratorë të akredituar për kryerjen e analizave të cilësisë së ujit të pijshëm?**

2. **A ka hartuar Ministria Strategji për eksploatimin e qëndrueshëm të inerteve (aluvioneve) nga lumenjtë?**

**3. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

**Pyetësori për MBPZHR**
**Lidhur me zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra**

*Sqarim hyrës:*
*Pyetjet e formuluara në këtë pyetësor janë bazuar në treguesit objektivisht të verifikueshëm të përcaktuar në Strategjinë Shtetërore për Ujëra për monitorimin e progresit në zbatimin e kësaj Strategjie dhe në Veprimet e Planifikuara për zbatimin e masave dhe Objektivave Strategjikë.*

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHFRYTËZIMI I UJËRAVE**

1. A kanë Kompanitë e Ujitjes Plane Investive?

2. A kanë Kompanitë e Ujitjes Plane të Biznesit?

3. Sa kanë qenë investimet në sisteme të ujitjes prej vitit 2017?

4. A ka hartuar Ministria plan afatgjatë për shfrytëzim të ujit për ferma të peshqve?

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MBROJTJA E UJËRAVE**

1. A ka hartuar Ministria për prodhuesit bujqësorë Udhëzues për përdorimin e plehërave organike?

2. A ka hartuar Ministria për prodhusit bujqësorë Udhëzues për përdorimin e biocideve?

3. Sa është popullsia urbane e kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura krahasuar me totalin e popullsisë urbane (%)?

**4. Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit**

**Pyetësori për Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU)**
**Lidhur me zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra**

*<u>Sqarim hyrës:</u>*
*Pyetjet e formuluara në këtë pyetësor janë bazuar në treguesit objektivisht të verifikueshëm të përcaktuar në Strategjinë Shtetërore për Ujëra për monitorimin e progresit në zbatimin e kësaj Strategjie dhe në Veprimet e Planifikuara për zbatimin e masave dhe Objektivave Strategjikë.*

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHFRYTËZIMI I UJËRAVE**

1. Sa është popullsia urbane me qasje në rrjet të ujësjellësit në raport me popullsinë totale urbane?
2. Sa është popullsia rurale me qasje në rrjet të ujësjellësit në raport me popullsinë totale rurale?  popullsia urbane totale (%)?
3. Sa është % e konsumatorëve që marrin furnizim 24 orësh?
4. Sa është niveli i përputhshmërisë së analizave të ujit me standarde të cilësisë kimike të ujit të pijshëm (%)?
5. Sa është niveli i përputhshmërisë së analizave të ujit me standarde të cilësisë mikrobiologjike të ujit të pijshëm (%)?
6. Sa është shkalla e humbjeve të ujit në nivel të sektorit (%)? Sa eshte shkalla e humbjeve komerciale të ujit (%)?
7. Sa është shkalla e arkëtimit të faturave të KRU-ve (%)?

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MBROJTJA E UJËRAVE**

1. Sa është popullsia urbane e kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura krahasuar me totalin e popullsisë urbane (%)?
2. Sa është popullsia rurale e kyçur krahasuar me totalin e popullsisë rurale (%)?
3. Sa është përqindja e trajtimit primar të ujërave të ndotura ne raport me totalin e ujërave të ndotura të gjeneruara (%)?
4. Sa është përqindja e trajtimit sekondar të ujërave të ndotura ne raport me totalin e ujërave të ndotura të gjeneruara (%)?
5. Sa është përqindja e faturave të ujërave të ndotura të paguara me kohë (%)?

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: QEVERISJA**

1. Sa janë investimet Kapitale në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit? (€)
2. Sa janë investimet Kapitale në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit në raport me planin? (% e zbatimit)
3. Sa janë investimet Kapitale në sektorët e ujërave dhe kanalizimeve në krahasim me BPV? (%)

## 5. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

**Pyetësori për IHMK**
**Lidhur me zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra**

*<u>Sqarim hyrës:</u>*
*Pyetjet e formuluara në këtë pyetësor janë bazuar në treguesit objektivisht të verifikueshëm të përcaktuar në Strategjinë Shtetërore për Ujëra për monitorimin e progresit në zbatimin e kësaj Strategjie.*

<u>Objektivi strategjik 1: Shfrytëzimi i Ujërave</u>

1. **Cili është proporcioni i trupave ujorë sipërfaqësorë që i nënshtrohen mungesës së ujit?**
   *<u>Sqarim:</u> Pyetja ka të bëj me numrin e trupave ujorë që nuk kanë pasur prurjen e pranueshme ekologjike. Përgjigjja mund të jepet nëse ka të dhëna për prurjet në trupat ujor dhe rrjedhimisht edhe të dhëna per atë se sa është prurja e pranueshme ekologjike në trupat ujorë në seksionet pas pikës së shfrytëzimit të ujit.*
2. **Cili është proporcioni i trupave ujorë nëntokësorë që arrijnë status të mirë sasior?**
   *<u>Sqarim:</u> Kjo pyetje mund të përgjigjet nëse është monitoruar statusi sasior i trupave ujor nëntokësor.*

<u>Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja e Ujërave</u>

1. **Sa është numri i trupave ujorë sipërfaqësorë që plotësojnë objektivat fiziko-kimik në raport e numrin total të trupave ujore sipërfaqësore (%)?**
   *Sqarim: Përgjigjja duhet të rezultojë nga monitorimi i parametrave fiziko-kimikë të trupave ujorë sipërfaqësor të cilët shërbejnë për përcaktimin e statusit të mirë ekologjik.*

2. **Sa është numri i trupave ujorë sipërfaqësorë që plotësojnë objektivat biologjike në raport me numrin total të trupave ujore sipërfaqësore (%)?**
   *Sqarim: Përgjigjja duhet të rezultojë nga monitorimi i parametrave biologjike të trupave ujorë sipërfaqësor të cilët shërbejnë për përcaktimin e statusit të mirë ekologjik.*

3. **Sa është numri i trupave ujore sipërfaqësore që plotësojnë objektivat hidro-morfologjike në raport me numrin total të trupave ujore sipërfaqësore (%)?**
   *Sqarim: Përgjigjja duhet të rezultojë nga monitorimi i hidro-morfologjik i trupave ujorë sipërfaqësor të cilët shërbejnë për përcaktimin e statusit të mirë ekologjik.*

4. **Sa është numri i trupave ujorë nëntokësorë që plotësojnë objektivat fiziko-kimike në raport me numrin total të trupave ujore nëntokësore (%)?**
   *Sqarim: Kjo pyetje mund të përgjigjet nëse është monitoruar statusi kimik i trupave ujorë nëntokësorë.*

5. **Sa është numri i trupave ujore nëntokësore që plotësojnë objektivat mikrobiologjike në raport me numrin total të trupave ujore nëntokësore (%)?**
   *Sqarim: Kjo pyetje mund të përgjigjet nëse është janë monitoruar parametrat mikrobiologjikë të trupave ujorë nëntokësorë.*

Objektivi Strategjik 3: Mbrojtja nga Ujërat

1. **Sa është sipërfaqja e zonave urbane me rrezik të lartë për vërshime ($km^2$)?**
   *Sqarim: Kjo pyetje mund të përgjigjet nëse është kryer vlerësimi i rrezikut nga vërshimet.*

2. **Sa është sipërfaqja e zonave jo-urbane me rrezik të lartë për vërshime ($km^2$)?**
   *Sqarim: Kjo pyetje mund të përgjigjet nëse është kryer vlerësimi i rrezikut nga vërshimet.*

Objektivi Strategjik 4: Qeverisja

1. **Monitorimi i ujërave sipërfaqësore**
   - Sa është numri i pikave të monitorimit?
   - Sa është numri i mostrave të marra?
   - Sa është numri i parametrave të analizuara?

2. **Monitorimi i ujërave nëntokësore**
   - Sa është numri i pikave të monitorimit?
   - Sa është numri i mostrave të marra?
   - Sa është numri i parametrave të analizuara?

## 6. Kompanitë Rajonale të Ujit

**Pyetësori për Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU)**
**Lidhur me zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra**

*Sqarim hyrës:*
*Pyetjet e formuluara në këtë pyetësor janë bazuar në treguesit objektivisht të verifikueshëm të përcaktuar në Strategjinë Shtetërore për Ujëra për monitorimin e progresit në zbatimin e kësaj Strategjie dhe në Veprimet e Planifikuara për zbatimin e masave dhe Objektivave Strategjikë.*

### OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHFRYTËZIMI I UJËRAVE

1. A kanë KRU-të Program/Strategji për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit (Ujit të Pafaturuar)?

2. Sa është zvogeluar shkalla e UPF prej vitit 2017 deri ne vitin 2021?
3. Sa është rritur shkalla e arkëtimit krahasuar me vitin 2017?
4. A kanë KRU-të plan për integrimin nën menaxhimin e tyre të sistemeve rurale të ujësjellësit dhe kanalizimit?
5. A kanë KRU-të plan për menaxhimin e thatësirave?

## 7. Kompanitë Rajonale të Ujitjes

**Pyetësori për Kompanitë e Ujitjes (KU)**
**Lidhur me zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra**

*Sqarim hyrës:*
*Pyetjet e formuluara në këtë pyetësor janë bazuar në treguesit objektivisht të verifikueshëm të përcaktuar në Strategjinë Shtetërore për Ujëra për monitorimin e progresit në zbatimin e kësaj Strategjie dhe në Veprimet e Planifikuara për zbatimin e masave dhe Objektivave Strategjikë.*

### OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHFRYTËZIMI I UJËRAVE

1. A kanë Kompanitë e Ujitjes Plane Investive?
2. A kanë Kompanitë e Ujitjes Plane të Biznesit?
3. Sa kanë qenë investimet në sisteme të ujitjes prej vitit 2017?
4. Sa është shkalla dhe përqindja e arkëtimit të faturave nga Kompania e Ujitjes?
5. Sa është shkalla e humbjeve të ujit? A matet uji që merret nga burimidhe uji që iu furnizohet shfrytëzuesve të ujit për ujitje?

Funded by
the European Union

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Let’s Do It Peja, zbatues i projektit “Promovimi i Qasjes Univerzale në Ujë të Pastër” dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Zyra në Kosovë.

Hulumtimi është realizuar nga OJQ Let’s Do It Peja
Adresa: Shtëpia e Kulturës, kati III
30000, Pejë, Kosovë
Email: letsdoitpeja@gmail.com
Tel:+383 49 124 548